

Dita e librit
Një trëndafil
dhe mesazhe
për Athinën

Fq.6



**SEANCË
"TANKU"**
Dëshmitarët
e mbrojnë
Gruevskin

Fq.4



Ju lumtë
Shkëndijë
**Lazim
Destani**

Fq.19



Koha

www.koha.mk



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3349 · e martë 24 prill, 2018

14°C | 30°C

15 DEN

EDITORIAL

**Vajzat
shqiptare,
nuse
Shumadije!**



Dhjetëra të rinj serbë për çdo muaj martohen me shqiptare të reja nga zonat veriore e qendrore të Shqipërisë. Për një nuse shqiptare paguhen 3 mijë e më shumë euro. Në zona të thella malore të Shumadisë të rinjtë serbë kanë vuajtur për martesë, mirëpo tani këtë problem ata nuk e kanë. Mjafton të blihet një fjalor serbisht-shqip, pastaj të ndiqen faqet e gazetave me shpallje dhe saora vendoset kontakti me ndërmjetësuesin...

Fq.2

RAJON

**Serbia e
vendosur
të pengojë
Kosovën**

Fq.16

GLOBI

**Iranianët në
krizë, blerja
e dollarit
arrin kulmin**

Fq.17



MBLEDHJE E KOMISIONIT QË MBIKËQYR ORGANET E INTELIGJENCËS

TRANSPARENÇË DHE NDRYSHIM MENTALITETI



Në pyetjen e gazetarëve se a po merren parasysh vërejtjet e Raportit të Pribes, Nikollovski tha se janë duke punuar në riformulimin e rasteve të diskutuara me qëllim, siç tha ai, të mos etiketimit të shqiptarëve. Përveç kësaj, shefi i DSK-së përjashtoi mundësinë e ekzistimit të qendrave për përgjim

Fq.3

Testohen 15-vjeçarët

Shkup, 23 prill - Nxënësit e shkollave të mesme janë përfshirë të hënën në testimet ndërkombëtare PISA të cilat i organizon OCDE-ja, me kërkesë paraprake të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Kjo është hera e tretë që nxënësit tanë bëhen pjesë e këtyre testeve, pas pjesëmarrjes së vitin 2000 dhe më vonë në vitin 2015, ku nxënësit nga Maqedonia dolën me rezultate shumë të dobëta sa i

takon shkathësive për një leximi me kuptim, matematikës logjike dhe njohurive nga shkencat natyrore. Pritshmëritë dhe synimi i MASH-it është përmirësim i imazhit të Maqedonisë në testimet e karakterit ndërkombëtarë sikurse është PISA 2018 dhe, me këtë braktisja e pozitave të fundit në listën e rangimit e cila do të publikohet vitin e ardhshëm. Në frymë të këtyre përpjekjeve, është punuar...

Fq.4



EDITORIAL

VAJZAT SHQIPTARE,
NUSE SHUMADIJE!

Emin AZEMI

Dhjetëra të rinj serbë për çdo muaj martohen me shqiptare të reja nga zonat veriore e qendrore të Shqipërisë. Për një nuse shqiptare paguhen 3 mijë e më shumë euro. Në zona të thella malore të Shumadisë të rinjtë serbë kanë vuajtur për martesë, mirëpo tani këtë problem ata nuk e kanë. Mjafton të blihet një fjalor serbisht-shqip, pastaj të ndiqen faqet e gazetave me shpallje dhe saora vendoset kontakti me ndërmjetësuesin. Nusët nga Shqipëria gjenden lehtë dhe ato i kanë çmimet e tyre, kurse tarifat i vendosin ndërmjetësuesit, të cilët një pjesë të lekëve e marrin për vete. Jo rralë ndodhë që dhëndurët serbë, të moshave mbi 40 vjeçare shkojnë në Shqipëri dhe pasi të njoftohen me familjarët e nuses 18 vjeçe, nuk kthehen zbrazët. Shqiptarët janë mikëpritës bujarë dhe të presin me "me bukë e kripë e nuse", por edhe kur të përcjellin ta ka ënda ti shohësh. Krushku e sajdis dhëndrin me nusen, ia bën gati me të gjitha nishanet dhe nën ritmin e "uzhičko kolo" e përcjellë deri në krye të katundit a lagjes, ndërkohë që diku sh nga gratë e kojshillakut i uron bijës së tyre që t'iu kthehet me këmbë të mbarë dhe mundësisht me një djalë në krah. Nusja e blerë tekta shkon në shtëpinë që i ngjan një ahuri bagëtish për mediat serbe shprehet e lumtur në familjen e burrit, sepse aty gjen nja dy pleq të kërrusur, që mezi presin rroktarllëkun e shqiptares, kurse pak më tej i dhuron mirëseardhje një tufë derrash, që po bëhej gati të hipë mbi grumbullin e plehut në mes të oborrit.

Lume Miliçević është shqiptarja e ve, të cilës burri i kishte vdekur disa vite më parë, mirëpo ajo kishte vendosur të mbetet në Serbi. Ajo njihet si shkuese apo ndërmjetësuese për martesat.

Lumja vazhdimisht organizon udhëtime dhe vizita të të rinjve serbë nga zonat rurale serbe drejt Shqipërisë, ku atje ajo grumbullon vajza dhe familje të interesuara për martesë.

Më pas ndërmjetësuesja organizon edhe vizitën e prindërve të vajzave në Serbi, për të parë se ku do të jetonin vajzat e tyre. Vetëm në zonën e Rashkës, Peshterit, Golijas, Javorit dhe Jadovikut janë martuar mbi 150 shqiptare me serbë dhe ato deri tani kanë krijuar familjet e tyre me shumë

fëmijë. "Večernje Novosti" shkruan se numri i martesave të reja me nuse shqiptare po shkon duke u rritur, ndërsa organizata "Rashka e Vjetër" organizon dhe ndërmjetëson falas për martesat udhëtimet e serbëve në Shqipëri. Kjo organizatë bën të ditur se nuk bëhet fjalë për ndonjë biznes, por vetëm për aktivitet human për moshohatisjen e fshatrave serbe. Sipas tyre, deri tani ajo ka bërë 300 martesat midis serbëve dhe shqiptarëve. Shtypi serbë njofton se në Shkodër ekziston agjencia e cila ndërmjetëson për martesat dhe serbët paguajnë mbi 3-4 mijë euro për një nuse shqiptare. "Po i ringjallim fshatrat. Në një fshat Buxhevo, 10 nuse shqiptare kanë lindur deri tash 12 fëmijë dhe është hapur shkolla sërish", theksoi një fshatar serb për "Večernje Novosti" të Beogradit.

Të gjitha informacionet për shitjen e vajzave shqiptare në viset e harruara të Serbisë mund t'i gjejmë në gazetën serbe. Mediave prestigjioze dhe investiguese të Tiranës nuk iu bëjnë përshtypje këto maskarallëqe që iu ndodhin par hundëve të tyre. Atyre nuk iu bën përshtypje kjo skllavëri e poshtë qeniesh të gjalla që bëhet pa u regjistruar madje as nga ndonjë shoqatë që mbron dinjitetin dhe liritë e njeriut.

I keni parë studiot televizive të Tiranës dhe analistët e gjithëlogjisë se si ua bajnë gajlen LGBTI-istave, por edhe marrëdhëniet e tendosura SHBA-Kore e Veriut, pa harruar ndikimin e ngrohjes globale në tregjet e minjve, paçka se temat si kjo e shitjes së vajzave shqiptare për besherat serbë, ende konsiderohen si anakronizëm, kurse gjithë ata që kanë kurajën të flasin për gjëra të tilla shpallen ose folkloristë ose patetikë të vonuar, pa harruar madje të të fusin edhe etiketën "antiserb". Ky pazar i pistë skllavo-pronar që po ndodhë para syve tanë, nuk do të kishte rentabilitetin vet, sikur të mos kishte mbështetje oportunitetin publik dhe mosreagimin e shtetit. Skenat e filmave me zëzak të lidhur që barteshin me anije nga njëri breg në tjetrin, i kishim menduar si prodhime fabulare të skenaristëve, mirëpo paskemi gabuar kur i kemi mbyllë sytë të shohim ngjarje reale përreth nesh, me protagonist-vajza, të cilat tani më nuk po aktojnë por po thurin një pëllhurë të re, sigurisht ndonjëherë që kishte harruar dikur Penelopa, me të cilën po mbulojnë vrazhdësinë e realitetit por edhe të relievit të zymtë atje diku prapa shumë maleve e brigjeve ku po vazhdojnë të jetojnë dhe të përtërijnë vatrat e shuara serbe.

VLERA UNIVERSALE E LIBRIT

"Dita Ndërkombëtare e Librit na kujton vlerën universale të librit si mjet i patejkalueshëm i shënimit të dijes, shkencës, letërsisë artit dhe komunikimit njerëzor.

Kjo ditë, përpos botimit, leximit dhe promovimit të librit, na fton për të mbrojtur të drejtën e autorit, përkatësisht vlerësimin e integritetit të krijuesve të vlerave diturore dhe shpirtërore. Kosova është pjesë e botës ku me ligj mbrohet e drejta e autorit.

Institucionet tona kulturore dhe arsimore duhet të bëjnë edhe më shumë për ta përkrahur librin, botuesin dhe lexuesin", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.



NËN MASKËN E MESISË, FSHIHET DJALLI

"Viteve të fundit edhe në mediat publike, po prezantohen dhe promovohen individ me të kaluar të dyshimtë, si mesie, si profet, si shpëtimtar të njerëzimit me aftësi të papara shëruese, madje edhe të njerëzve të pashpresë. Këtyre mashtruesve, për shkak të lakmisë në pasuritë e tyre, (të fituara me krim) dhe frikës nga afërsia që ata kanë me disa udhëheqës, (si ata), po ua krijojnë hapësirën e promovimit të mashtrimeve edhe në mediat shtetërore të Kosovës.

Për të ikur nga e kaluara kriminale e tyre, këta e kanë ndryshuar edhe pamjen e jashtme dhe janë shndërruar në mesie e profet shpëtimtar. I kanë rritur e lyer flokët dhe mjekrat me ngjyrë të kuqërremtë dhe po duken sikur të sapodalë nga parajsja.

Po ti shikosh me vëmendje, ata duken se janë të sëmurë mental. Madje me sindrome që as Frojdi nuk ka arritur ti evidentoj. Ka të ngjarë që këta "shenjtor", krimet e bëra po i ndjekin kudo, sa po i detyrojnë të marrin pamje të Krishtit dhe profetëve të tjerë, për tu dukur jo vetëm të pafajshëm, por edhe të shejt. Për fat të keq, disa njerëz që kanë merita për çlirimin e Kosovës, kanë qenë (e disa ende janë), argat të tyre.

Ata e kanë humbur emrin e vet dhe të familjeve të tyre, duke iu shërbyer të tillëve. Po s'ka gjë! Nëse nuk i shohim edhe këta me pamje të ndryshuar, së paku nuk do të na vie ndoht që ua kemi dhënë dorën", ka shkruar veprimtari dhe studiuesi Nijazi Idrizi në profilin e tij në Facebook.

RRUGËTIMI NË DREJTIM TË GABUAR

"Udhëtimi në rrugë të gabuar bëhet sipas rregullave. Edhe në rrugën e gabuar i përmbahen rregullave.

Edhe ata ndalojnë në semaforin e kuq, edhe ata këqyrin kush ka përparësi kalimi, Edhe ata frenojnë aty ku ka STOP. E kështu me radhë. Por ama, përmbajtja e rregullave të qarkullimit në udhëtimin e drejtimit të gabuar vetëm çka të thellon në ecjen drejt të gabuarës", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



MEDIACitate

SERBIA DUHET
TË JAPË
LLOGARI PËR
PERSONAT
E PAGJETUR

Shteti i Serbisë duhet të japë përgjigje dhe të japë llogari për fatin e personave të pagjetur, kanë thënë zyrtarë të lartë të institucioneve të Kosovës, më rastin e nisjes së shënimit të Javës së të Pagjeturve. Edhe 19 vjet pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, 1.658 persona konsiderohen të pagjetur. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj është zotuar se Qeveria e Kosovës nuk do të ndalet se kërkuesit trupat e personave të pagjetur gjatë luftës 1998-99 dhe që shteti serb, siç ka thënë ai, duhet të përgjigjet dhe të japë llogari për këtë. Kryeministri Haradinaj, nën patronatin e të cilit është organizuar "Java e të Pagjeturve", ka thënë se plagët e luftës së fundit nuk mund të mbyllën dhe nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa ndriçimin e plotë të vërtetës së luftës në Kosovë. "Java e të Pagjeturve na rëndon dhe na sjellë vuajtje dhe dhimbje për mijëra qytetarët, fati i të cilëve ende nuk është zbardhur nëntëmbëdhjetë vjet pas lufte. Ju uroj të keni forcën, kurajon dhe të shohin përpara. Të jemi bashkë dhe t'i dalim përballë kësaj teme që është më e dhimbshme që ka Kosova, plaga e luftës", ka thënë Haradinaj. Në anën tjetër, përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe familjarët e personave që mungojnë, kanë kërkuar nga autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare që t'i bëjnë presion Serbisë për zgjidhjen e këtij problemi. Bajram Qerkini, kryetar i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Pagjetur, ka thënë se Serbia e di se ku gjenden trupat e personave të pagjetur. "Ju duhet të kërkoni nga autoritetet ndërkombëtare që të bëjnë presion tek autoritetet serbe, që të kthehen trupat e pagjetur. Ata e dinë se ku gjendet secila pjesë e trupit. Të gjallë ose të vdekur le t'i kthejë në Kosovë", ka thënë Qerkini.

(REL, 23 prill)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR PJETËR BOGDANIN?

Pjetër Bogdani (rreth 1625-1689) njihet si shkriktari më i shquar i letërsisë shqiptare të vjetër. Lindi në Gur të Hasit (Kukës). Kreu studimet e larta teologjike e filozofike në Romë dhe mori titullin doktor. Shërbeu së pari si famullitar në Pult e Prizren, më 1656 u emërua peshkop i Shkodrës, më 1677 kryepeshkop i Shkupit.

Mori pjesë në lëvizjet çlirimtare që nisën në këto vite, sidomos në Shqipërinë veriore e verilindore. Pjetër Bogdani luftoi për ta pasuruar e përpunuar gjuhën shqipe, gjurmoi dhe vuri në qarkullim fjalë e shprehje të vjetra të lëna në harresë, krijoi edhe fjalë të reja, duke bërë përpjekjet e para për krijimin e termave në ndonjë degë të shkencës. Vdiq në Prishtinë.

MBLEDHJE E KOMISIONIT QË MBIKËQYR ORGANET E INTELIGJENCËS



TRANSPARENCË DHE NDRYSHIM MENTALITETI

Në pyetjen e gazetarëve se a po merren parasysh vërejtjet e Raportit të Pribes, Nikollovski tha se janë duke punuar në riformulimin e rasteve të diskutuara me qëllim, siç tha ai, të mos etiketimit të shqiptarëve. Përveç kësaj, shefi i DSK-së përjashtoi mundësinë e ekzistimit të qendrave për përgjim

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 23 prill - Drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Goran Nikollovski, të hënë në Parlament bëri të ditur se aktualisht - në këtë institucion po punohet në ndryshimin e mentalitetit dhe në metodologjinë e re në ndjekjen e komunikimeve.

"Gjatë shqyrtimit të Raportit, më shumë është biseduar se si të ndryshohet mentaliteti në DSK, si të kemi transparencë më të madhe të punës në këtë institucion dhe për metodologjinë e punës", tha Goran Nikollovski gjatë konferencës për shtyp pas mbajtjes së mbledhjes me dyer të mbyllura të komisionit që mbikëqyr punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe të Agjencisë për Zbulim. Në pyetjen e gazetarëve se pse ende vazhdohet që Komisioni të mbajë mbledhje me dyer të mbyllura, Nikollovski tha se kjo u bë për shkak se shërbim

met e Parlamentit kërkuar ashtu, por se sipas tij, ka pasur tema të karakterit klasifikues e që nuk duhej të ishin publike.

Në lidhje me rastin e "Sopotit" dhe rastin "Monstra", Goran Nikollovski tha se, nëse janë keqpërdorur shërbimet e DSK-së, informatat duhet kërkuar tek Prokuroria Speciale me të cilën, shtoi ai, janë në gjendje të bashkëpunojnë nëse kërkohet një gjë e tillë. Në pyetjen e gazetarëve se a po merren parasysh vërejtjet e Raportit të Pribes, shefi i DSK-së tha se janë duke punuar në riformulimin e rasteve të diskutuara me qëllim, siç tha ai, të mos etiketimit të shqiptarëve.

Përveç kësaj, Nikollovski përjashtoi mundësinë e ekzistimit të qendrave për përgjim siç kanë ndodhur në të kaluarën. "Lidhur me përgjimet, gjithçka po punohet sipas Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, nuk do të ketë biseda të përgjuara jashtë ligjit e as qendra për përgjim nuk ka", tha Nikollovski. Deputeti i LSDM-së, Stefan Bogoev, anëtar në Komision tha para gazetarëve se në punën e organeve të

inteligjencës, duhet të vijë në shprehje profesionalizmi dhe transparencja dhe se kanë diskutuar të gjitha mundësitë që ky institucion të mos i përsërit ato që kanë ndodhur në të kaluarën.

Ndryshe, në Parlament u shty për të mërkurën debati mbi Raportin gjashtë mujor për punën e Prokurorisë Speciale Publike. Në Komisionin për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive kishte debat mes deputetëve të LSDM-së dhe atyre të VMRO-së për Raportin vjetor të Komisionit për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë te informatat me karakter publik për vitin 2017, për shkak të mos prezencës as të kryetarit dhe as ndonjë anëtar të këtij komisioni. "Ju duhet të mbronni atë që keni thënë vet, pra transparencën. Nuk mund të votojmë një Raport kur kryetari nuk është këtu. Kiracovski tashme njihet për thyerje të Rregullores disa herë. E kuptojmë pse e bëni këtë, sepse nuk doni të diskutoni mbi ankesat e arritura në këtë komision. Në vitin 2016, ishin 619 ankesa, ndërsa në viti 2017 kur ju

jeni në pushtet kemi 758 ankesa, pra kemi një rritje enorme", tha deputetja VRMO-së, Ana Llashkova.

Me kërkesën jo vetëm të deputetëve të VMRO-së, por edhe atyre të LSDM-së, kryetari i Komisionit Aleksandër Kiracovski u pajtua që të mos pranohet Raporti, përderisa nuk vijën të prezantojë atë ndonjëri nga anëtarët e Komisionit për qasje të lirë deri tek informatat me karkatur publik. Ndryshe, lidhur me reformat në sistemin e sigurisë, pati prononcim nga Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski. Ai tha se ministria që ai drejton në mënyrë të hollësishme i analizon të gjitha aspektet e vlerësuar në dokumentin e Departamentit të Shtetit dhe shtoi se për reformë të strukturave të sigurisë veç më janë ndërmarrë hapa konkrete, janë harmonizuar ligje të cilat janë miratuar në Kuvend dhe se ato reforma duhet të funksionojnë deri nga fundi i vitit në pajtim me afatin e përmbajtjes në ligjet. Ai shtoi se është rritur kontrolli që bëhet në kuadër të vet MPB-së dhe se ai është i kënaqur nga ajo që deri tani është bërë.

KOMISIONI PËR SISTEM POLITIK NUK I MIRATOI RAPORTET

Xhorxhi Sllamkov, kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik më 17 prill ka dhënë dorëheqje deri te Kuvendi për, siç ka theksuar, shkaqe personale. Raporti vjetor për punën e Komisionit për qasjen e lirë sot ishte në rend dite të Komisionit parlamentare për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, por nuk kishte përfaqësues të tij që ta elaborojë. Komisioni nuk e miratoi raportin e Komisionit për qasje të lirë, si dhe raportin e punës së Komisionit shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në fushën e

mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse. Pjesa më e madhe e debatit midis deputetëve të shumicës qeveritare dhe opozitës ishte dedikuar në atë se a duhet ose nuk duhet të ketë përfaqësues të këtyre komisioneve që t'i shpjegojnë raportet vjetore. Përfaqësues nuk ishte dërguar as nga Komisioni shtetëror për vendosje në shkallë të dytë në fushën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse. Njerëzit e parë të këtij komisioni ishin emëruar para një periudhe të caktuar.

Neto rroga mesatare në shkurt 23.158 denarë

Shkup, 23 prill - Neto rroga e paguar mesatare mujore për një të punësuar, në shkurt të vitit 2018 arrin 23.158 denarë dhe sipas të dhënave të publikuara të Entit shtetëror të statistikës shënon rritje prej 3.6 për qind në krahasim me shkurtin e vitit të kaluar. Rritja i përket, para se gjithash, rritjes së neto-rrogës së paguar mesatare mujore për një të punësuar në sektorët: Miniera dhe nxjerrje e gurëve për 14.5 për qind, industri përpunuese për 10.7 për qind dhe informacione dhe komunikimeve për 10.5 për qind. Zvogëlimi i neto-rrogës së paguar mesatare mujore për një të punësuar, në krahasim me muajin e kaluar, është vërejtur në sektorët: Art, argëtim dhe rekreacion për 26.4 për qind, Transport dhe deponim për 11.7 për qind dhe Minierë dhe nxjerrje e gurëve për 9.9 për qind. Bruto rroga e paguar mesatare mujore për një të punësuar, në shkurt të vitit 2018 arrin 33.994 denarë.

Emri, gjasat për zgjidhje janë 50-50

Athinë, 23 prill) - Gjysmë-gjysmë janë gjasat për zgjidhje të çështjes me emrin sipas informatave që rrjedhin nga MPJ greke, thotë nënkryetari i partisë greke Demokracia e Re, Kostis Haxidakis në intervistë për radion e agjencisë greke të lajmeve "Praktorio fm". Siç lajmëron korrespondentja e MIA-s nga Athina, Haxidakis komenton se "punët nuk janë të thjeshta" në negociatat për emrin. "Nga vetë Minsitria e Punëve të Jashtme rrodhi se gjasat tashmë janë 50-50, përderisa ndërkaq deri para do kohe ministri ishte hiper i sigurt se do të sjellë zgjidhje të shkëlqyeshme. Ne e kemi thënë qartë, posaçërisht në deklaratat e fundit nga ana e IRJM-së, se zgjidhja për shkupjanët nuk do të jetë erga omnes, se tashmë po parashtrrohet një pyetje thelbësore lidhur me negociatat", tha Haxidakis, transmetoi agjencia greke e lajmeve ANA-MPA.

Më 1 Maj marsh dhe kërkesa sindikale

Shkup, 23 prill - Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë pas disa viteve pushim këtë vit organizon marsh të 1 Majit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punës. Nën moton "Rrugët janë të ndryshme, qëllimi është një" marshi do të fillojë para ndërtesës së Lidhjes së Sindikatave të Maqedonisë dhe do të vazhdojë para Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Sindikalistët do të kërkojnë ligj më të mirë për marrëdhënie të punës, regres për pushimin vjetor për të gjithë punëtorët, marrëveshje të përgjithshme kolektive më të mirë për sektorin privat dhe publik. Ata do t'i thonë stop edhe mobingut dhe për rritjen e kufirit të moshës për pensionim. "Kthehemi në rrugët tradicionale. Vendimi është sjellë njëzëri nga organet dhe trupat më të larta. Të gjithë kryetarët dhe këshilltarët e sollën vendimin që më 1 Maj të marshohet dhe të thuhet kërkesat e punëtorëve", theksoi kryetari i LSM-së, Darko Dimovski në konferencën e sotme për media. Kërkesat sindikaliste, siç tha, janë dorëzuar deri te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Nga LSM-ja theksojnë se duhet të përpilohet ligj i ri për marrëdhënie të punës ku do të rishikohen nenet ekzistuese dhe do të futen të rinj, ndërsa një nga çështjet për të cilat do të bisedohet janë kontratat me afat të caktuar. Marshi i 1 Majit përputhet edhe me 110 vjetorin e lëvizjes sindikaliste në Maqedoni.

PËR HERË TË TRETË PJESË E TESTIMEVE PISA

TESTOHEN 15-VJEÇARËT

Pritshmëritë dhe synimi kanë përmirësimin e imazhit të Maqedonisë në testimet e karakterit ndërkombëtarë sikurse dhe braktisja e pozitave të fundit në listën e rangimit për PISA 2018, për rezultatet që do të publikohet vitin e ardhshëm

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 23 prill - Nxënësit e shkollave të mesme janë përfshirë të hënën në testimet ndërkombëtare PISA të cilat i organizon OCDE-ja, me kërkesë paraprake të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH). Kjo është hera e tretë që nxënësit tanë bëhen pjesë e këtyre testeve, pas pjesëmarrjes së vitin 2000 dhe më vonë në vitin 2015, ku nxënësit nga Maqedonia dolën me rezultate shumë të dobëta sa i takon shkathtësive për një leximi me kuptim, matematikës logjike dhe njohurive nga shkencat natyrore.

Pritshmëritë dhe synimi i MASH-it është përmirësim i imazhit të Maqedonisë në testimet e karakterit ndërkombëtarë sikurse është PISA 2018 dhe, me këtë braktisja e pozitave të fundit në listën e rangimit e cila do të publikohet vitin e ardhshëm.

Në frymë të këtyre përpjekjeve, është punuar që të motivohen nxënësit dhe ta marrin seriozisht çështjen e testimit, respektivisht të mos e braktisin testimin por të qen-



drojnë deri në fund dhe tu përgjigjen të gjitha pyetjeve të testit. I përfshirë në këtë proces mjaft të rëndësishëm ka qenë edhe Gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, ku sipas një përzgjedhje të rastësishme paraprake ishte caktuar që të testohen 70 nxënës, të lindur në vitin 2002. Moshë 15 vjeçare e nxënësve që marrin pjesë në testim është kriteri i përbashkët për gjithë nxënësit që testohen në nivel botëror, ashtu edhe i 5500 nxënës nga Maqedonia që këtë vit bëhen pjesë e testeve PISA 2018 e që janë kryesisht nxënës në vitin e parë të shkollës së mesme.

Faruk Zeqiri, drejtor i ZLM-së, thotë se pjesëmarrja e nxënësve të këtij gjimnazi në testim ishte masive. "Nga 70 nxënës që ishin caktuar të testohen për PISA 2018 munguan vetëm 4 nxënës, të cilët në ndërkohë kanë ndryshuar shkollën pra nuk janë më nxënës të ZLM-së. Gjithë të tjetër erdhën në kohë dhe testimi rrodhi sipas dinamikës së parapare", shprehet Zeqiri. Ai, tre-

gon gjithashtu se motivimi i nxënësve ka qenë maksimal. Sipas udhëzimeve të MASH-it, është punuar me nxënësit që ti motivojmë dhe vetëdijësojmë për rëndësinë që kanë rezultatet e këtij testimi, plotëson më tej drejtori. "Asnjë test nuk është kthyer i pa plotësuar. Nxënësit kanë qëndruar deri në fund dhe sikurse u informuam nga tetstatorët e shkolis dhe vëzhguesit e MASH-it, nxënësit kanë qenë të impenjuar gjatë kohës së testimit", vëren Zeqiri.

Matja e njohurive bazike të nxënësve, që bëhet përmes testeve të standardizuara ngërthejnë pyetje nga gjuha amtare, matematika dhe shkencat natyrore, të njohura si testimet PISA. Testimi zgjat 3 orë dhe i gjithë procesi ndiqet nga dy testatorë, të cilët janë zakonisht profesorë të shkollës dhe një vëzhgues i jashtëm i cili përfaqëson Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA). Në Byro, paraprakisht është themeluar një qendër përkatëse për koordinimin e gjithë

procesit të testeve ndërkombëtare PISA në Maqedoni dhe ku përfshihen punët përgatitore, realizimi i testimit, komunikimi me qendrën e testeve PISA 2018, dërgimin e rezultateve, pranimin e ranglistave dhe analizat që pasojnë pas publikimit të rezultateve. Testimi i fundit në vitin ka marë oesjë Maqedonia është ai i vitit 2015. Rezultate e publikuara një vit më vonë na zbritën në vendin e 69 për lexim dhe shkencë dhe në vendin e 68 për matematikë, në mesin e 72 vendeve pjesëmarrëse. Kështu, nga 493 pikë sa ishte mesatarja e nxënësve nga të gjitha shteteve pjesëmarrëse në shkencë, nxënësit nga Maqedonia arritën të fitojnë 384 pikë. Në lexim nga 493 pikë e mesatares së arritur në nivel të përgjithshëm, nxënësit tanë fituan 352 pikë, ndërsa në matematikë nga mesatarja 490 pikë fituan 371 pikë. Këta rezultate për testimet e vitit 2015 e radhitën Maqedoninë në një grup me Kosovën, Algjerinë dhe Republikën Domenikane.

Ligj i ri për mbrojtje më efikase nga diskriminimi

Shkup, 23 prill - Zgjerimi i bazave për diskriminim, përparim të punës së Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi dhe profesionalizmi i saj me qëllim të zgjidhjes më efikase të ankësive, definim të kompetencave të tij edhe kur ato transferohen në gjykatë, parashihet propozim-ligji i ri për mbrojtje nga diskriminimi, për të cilin dje u mbajt debati publik. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska, vlerëson se kjo zgjidhje ligjore është e mirë, sepse siç tha, është përputhur me ligjvënien evropiane, standardet ndërkombëtare, por jep edhe angazhim të vërtetë se kjo Qeveri dhe shteti kanë për qëllim t'i mbrojnë qytetarët nga diskriminimi. "Me ligjin jo



vetëm që i zgjerojmë bazat, por japim mundësi që profesionalisht të vendoset për paraqitje ose iniciativa për diskriminim e bërë. Që nënkupton se tani kemi tre nivele. Një se kemi administratë profesionale dhe eksperte, e cila do ta mbështetë Komisionin, kemi komisarë të cilët nuk do të zgjidhen

nga partitë politike, por do të jenë ekspertë, por edhe Komisioni do të mund të formojë trup këshillëdhënës nëse për diçka nuk ka informacione dhe njohuri të mjaftueshme", tha ministria Carovska. Por, tha ajo, nuk duhet gjithçka të mbetet në zgjidhje ligjore, por të punohet edhe në implementimin

e tyre. Në qoftë se secili nga ne, tha, në praktikë diskriminon, dhe nuk vendoset në anën tjetër shumë vështirë do ta pengojmë diskriminimin vetëm me ligje. Përfaqësuesi i OSBE-së në Maqedoni, Xhef Gollidshajn, thotë se zgjidhja e tillë ligjore do ta përforcojë mbrojtjen nga diskriminimi

dhe siç tha, do të ndërtojë shoqëri të njëjtë për të gjithë. Ai paralajmëroi se në të ardhmen OSBE-ja do të vazhdojë ta mbështesë procesin e mos diskriminimit, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, organizatat civile, por edhe Sekretariati i Komisionit që do të formohet pas sjelljes së ligjit.

Silva Peshiq nga Zyra e përfaqësuesit të lartë të KB-së në Maqedoni, thotë se zgjidhja e mirë ligjore është e rëndësishme jo vetëm për ata të cilëve u nevojitet mbrojtje, por edhe për ata të cilët duhet të veprojnë që t'i mbrojnë. Ligji i mirë, tha, jep tregues të qartë se si këta persona të veprojnë gjatë mbrojtjes së qytetarëve nga diskriminimi.

(Z.V)

TË PUNËSUARIT NË MPB DËSHMOJNË NË LËNDËN "TANK"

DËSHMITARËT E MBROJNË JANKULLOVSKËN DHE GRUEVSKIN



Tre dëshmitarët e së hënës, të punësuar në MPB, thanë se nuk kanë arritur të dalin në vigjilje të nevojave për sigurinë e delegacioneve të huaja, sepse automjetet kohë të gjatë kanë qenë duke u rregulluar

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 23 prill - Në Gjykatën Penale në seancën e djeshme gjyqësore për lëndën e PSP-së "Tank" deklarata kanë dhënë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në Gjykatë edhe pse ishte paralajmëruar, nuk erdhi të dëshmojë Dejan Mitrevski-Urko, i cili një periudhë ishte shef i sigurimit të ish kryeministrit Nikolla Gruevski. Mbrojtja e Gruevskit nuk ishte informuar pse Urko nuk u paraqit në Gjykatë, për shkak të së cilës gjykatësja Dobrilla Kacarska kërkoi ta thërrasin gjatë ditës sepse në të kundërtën mund të rikthehet si dëshmi.

Deri më tani kanë dëshmuar katër dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja, të cilët theksuan se furnizimi i "mercedesit" të ri ishte i nevojshëm, sepse automjeti i vjetër shpesh herë kishte defekte dhe nuk ishte i sigurt për transportin e "vip" personave. I pari në Gjykatë të hënës dëshmoi Viktor Belevski, i punësuar në MPB nga viti 2002 deri në vitin 2006. Ai ka qenë shef i sigurimit të ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska. Belevski tha se mes automjeteve të cilat i kanë pasur për personat vip, kanë pasur një mercedes të vitit 1998, i cili gjatë tërë kohës ka pasur defekte. Ai shtoi se ka pasur grindje verbale me ministren Jankul-

lovska, sepse ka kërkuar që automjeti të tërhiqet, ndërsa ajo ka insistuar të shfrytëzohet, sepse nuk kanë pasur tjetër.

Dëshmitari tha se nuk kanë arritur të dalin në vigjilje të nevojave për sigurinë e delegacioneve të huaja, sepse automjetet kohë të gjatë kanë qenë duke u rregulluar. Sigurimi, siç shtoi Belevski, ka kërkuar të tërhiqen automjetet e vjetra dhe të furnizohen automjete të reja. Ai para Gjykatës shpjegoi një situatë në vitin 2011, kur me ministren Jankullovska ishin në takim me qytetarët në Jegunoc, ku ka ndodhur përleshje e armatosur midis bandës kriminale dhe policëve dhe ata ishin në mes të zjarrit. Pasi nuk kishte automjet të blinduar, e kanë vendosur në një objekt, i cili sipas tij, ishte i sigurt dhe ka urdhëruar të sigurojë automjet të blinduar për ta nxjerrë ministren nga shtëpia.

Belevski tha se për "Mercedesin" nuk mund të thotë se cilët vip "persona" e kanë shfrytëzuar, ndërsa për delegacionet e huaja ka parë në media, sepse nuk ka disponuar me të. Dëshmitari i dytë, Sasho Minkovski, gjithashtu i punësuar në MPB, ishte sigurim i presidentit të Maqedonisë, por edhe si shofer i eksport-automjetit. Në vitin 2010 kur ka drejtuar eksport-automjet, ka parë se automjetet nuk i kënaqin kushtet për siguri dhe kanë kërkuar

deri tek shefat të furnizojnë automjete të reja. "Mercedesin" e ri, siç tha, e kanë shfrytëzuar vetëm për jashtë Shkupit.

Në deklaratën e tij para Gjykatës, dëshmitari Rade Kolev, i punësuar në MPB nga viti 1995, ndërsa nga viti 2007 në Sektorin për sigurimin e kryeministrit, tha se nuk kishin mundësi 100 për qind ta garantojnë sigurinë e vip personave, sepse shumë herë kryeministrin e kanë vozitur edhe me automjet i cili nuk ishte i blinduar, sepse ai i blinduari shumë shpesh ishte prishur. Edhe kolegu i tij, Sashe Spasovski, i punësuar në MPB nga viti 2007 në sigurimin e kryetarit të Qeverisë si dhe dëshmitarët paraprakë treguan për përdorimin e automjeteve të reja. Në lëndën "Tank" janë të akuzuar ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ministria e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska dhe ish ndihmësministri në MPB Gjoko Popovski. Para dy seancave Gjykata mori vendim ta ndajë procedurën për Jankullovska për shkak të "shtatzënisë së rrezikshme". Në seancën e kaluar më shumë se pesë orë deklarata kanë dhënë 11 dëshmitarë të mbrojtjes. Ata theksuan se furnizimi i "Mercedesit" të ri ka qenë i domosdoshëm, sepse automjeti i vjetër shpesh është prishur dhe nuk ka qenë i sigurt për transportin e personaliteteve "vip".

Një kosovar ndërroi jetë në një aksident në Shkup

Shkup, 23 prill - Një shtetas i Kosovës dje pasdite ndërroi jetë pasi që humbi kontrollin mbi automjetin dhe u përplas në një shtyllë betoni në bulevardin "Nikolla Karev" në Shkup. Policia njoftoi se dje në

orën 17:00 në Shkup në bulevardin "Nikolla Karev" SH.H. (48) nga Kosova, ka drejtuar automjetin "mercedes" me targa të Kosovës, ka humbur kontrollin ndaj automjetit dhe është përplasur në një

shtyllë betoni. Pas aksidentit në gjendje të rëndë u transportua në Kompleksin e Klinikave "Nënë Tereza" ku u konstatua se ka ndërruar jetë. Është bërë ekspertiza në vendin e ngjarjes.

KRONIKË

Shtypet me veturë një këmbësor

Një këmbësor 53-vjeçar nga fshati Bukoviq i Shkupit e ka humbur jetën pasi në të është përplasur një automobil në autostradën "Nënë Tereza". Mbrëmë rreth orës 20:55 minuta në autostradën 'Nënë Tereza' në zonën e fshatit Bukoviq, shkupjani A.A. (23) duke e drejtuar automjetin motorik 'Audi A4' me targa të Shkupit është përplasur në këmbësorin B.I. (53) nga fshati Bukoviq, rrethina e Shkupit. Në këtë aksident këmbësori nga lëndimet e marra ka vdekur në vendin e ngjarjes. Është kryer inspektim", kumtoi MPB-ja.

Varroset Fatos Islami

Personi me iniciale B.H. nga Tetova i punësuar në Agjencinë për Sigurime, të dielën rreth orës 16.20, ka paraqitur se në rrugën për në Kalanë e Tetovës, gjatë patrullimit ka vërejtur një person në gjendje të shtrirë, i cili nuk ka treguar shenja jete. Në vendin e ngjarjes, menjëherë janë dërguar ekipe të SPB-Tetovës, dhe është konstatuar se, bëhet fjalë për 23-vjeçarin Fatos Islami nga fshati Sellcë i Tetovës. Sipas policisë, ai ndërruar jetë në vendin e ngjarjes kurse mjeku ligjor, i cili brenda kohe ka arritur në vendngjarje, nuk ka vërejtur shenja të dhunës. Pas mbarimit të hetimeve trupi i pa jetë i Fatos Islamit i është dorëzuar familjes për varrim.

Gjendet marihuanë në Tetovë

Pjesëtar të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të dielën rreth orës 17.30 në Bllok 82 në Tetovë, në afërsi të një shitore në terrasën e ndërtesës, kanë gjetur në një qese najloni me 19 paketime të vogla me lëndë barishtore (marihuanë), e cila peshonte rreth 48 gram, informon policia e Tetovës. Lëndët e gjetura, për të cilat SPB Tetovë, posedon informacione kush e ka lënë në atë vend, janë fotodokumentuar dhe marrë për ekspertizë. Po merren të gjitha masat dhe aktivitetet për gjetjen e personit, i cili ka lënë marihuanën në atë vend dhe në zbardhjen e plotë të rastit.

Aksidentohet biçiklisti nga Shqipëria në Tetovë

Të dielën mbrëma rreth orës 23.50, në trotuarin në Bulevardin e rrugës së Ilindenit ka ndodhur aksident ku vetura "Ford" me targa të Tetovës, e drejtuar nga personi me iniciale N.S. 48 vjeçar nga fshati Reçicë e Madhe dhe një biçikletë e drejtuar nga shtetasi i Shqipërisë me iniciale F.D. nga qyteti i Pogradecit. Vozitësi e ka lëshuar vendin e ngjarjes, kurse më pas është vetëparaqitur në polici. Në aksident biçiklisti ka marrë lëndime të rënda trupore frakturë në shpatullën e djathtë, ku me veturë tjetër është dërguar, në Spitalin klinik të Tetovës, për dhënien e ndihmës së parë mjekësore. Sipas informatave të para nga hetimet e kryera, shkak i aksidentit është mosrespektimi i përparësisë kalimit në rrugë, derisa dëmi material llogaritet gjithsej 30 mijë denarë. (U.H)

DITA BOTËRORE E LIBRIT DHE TË DREJTAVE TË AUTORIT

NJË TRËNDAFIL DHE MESAZHE PËR ATHINËN

Mesazhi i Maqedonisë që këtë herë u lexua nga ministri i Kulturës, Robert Alagjovovski, përveç apelit për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë e shkruar, të drejtat e librit dhe autorit drejtoi edhe mesazhin politik ndaj Greqisë, përkatësisht Athinës që këtë vit është kryeqendra botërore e librit



Koha Evis HALILI

Shkup, 23 prill - Me trëndafila dhe libra, mesazhe për të mbrojtur të gjithë ata që shkruajnë dhe botojnë dhe për promovimin e vazhdueshëm të shkrimit dhe leximit është shënuar 23 prilli - Dita botërore e Librit dhe e të Drejtave të Autorit Libri. Aktiviteti qendror është zhvilluar në Bibliotekën "Klementi i Ohrit", ku përveç programit më këngë, recitime, kërcime janë lexuar mesazhet për festën e librit. Mesazhi i Maqedonisë që këtë herë u lexua nga ministri i Kulturës Robert Alagjovovski, përveç apelit për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë e shkruar, të drejtat e librit dhe autorit drejtoi edhe mesazhin politik ndaj Greqisë, përkatësisht Athinës që këtë vit është kryeqendra botërore e librit.

"Kur Athina është kryeqendra e

librit dëshira jonë e padyshimtë është që të festojmë së bashku, me fqinjët dhe me të gjithë njerëzimin, pikërisht në frymën e misionit që ka libri, si ndërtues i urave të mirëkuptimit dhe dialogut për krijimin e vlerave të përbashkëta dhe një të ardhmeje më të mirë për të gjithë... Librat janë dëshmitarët e kohës, të kapaciteteve njerëzore dhe përpjekjeve për të krijuar botëra reale dhe imagjinare, por edhe për t'iu përçarur njerëzve mesazhet e një jete të pasur, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe tolerancën. Libri është një misionar i dritës së diturisë, simbol i shpresës civilizuese, fanari i përparimit dhe dialogut që duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë, si thelbin e ekzistencës njerëzore", thotë ministri i Kulturës Robert Alagjovovski në mesazhin me rastin e 23 Prillit.

Në mesazhin e drejtorit gjeneral të UNESCO, Odre Azule, festimi që i bëhet shkrimit, leximit, përkthimit, botimit, të cilat lartësojnë dhe relizojnë njeriun, në fakt janë festë për lirinë e shprehjes dhe publikimit.

"Libri ngërthen dy prej lirive themeltare të njeriut, atë të shprehjes dhe të publikimit. Këto liri janë të brishta dhe përballen me një sërë sfidash, që nga rishikimi i të drejtave të autorit dhe diversitetit kulturor, përmes kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj autorëve, gazetarëve dhe botuesve kudo në botë e deri tek dhunimi i tyre, si shkatërrimi i dorëshkrimeve dhe librave. Detyra jonë është që t'i mbrojmë këto liri kudo në botë, të promovojmë leximin dhe shkrimin, të luftojmë analfabetisimin dhe të forcojmë fundamentet e pa-

qes, por edhe të mbrojmë e të shpërfaqim të gjitha profesionet që lidhen me librin dhe autorëve të tij", thuhet në mesazhin botëror të këtij viti. Dita botërore e librit supozohet se e ka origjinën nga Katalonjë (Spanjë), ku atij që blinte një libër, i dhurohej edhe një trëndafil. Por kur u konkludua se libri historikisht ka qenë instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive, si dhe mjeti më efikas për ruajtjen e tyre UNESCO shpalli 23 prillin si Ditën Botërore të Librit, datë kjo që janë ndarë nga jeta Shekspiri, Servantesi dhe Garcilaso de la Vega. Zyrtarisht shënohet që prej vitit 1995 nga UNESCO dhe në mesazhet e kësaj organizate çdo vit aktualizohen çështjet që lidhen me të drejtat e lirisë së shprehjes, promovimit të leximit, luftën kundër analfabetizmit, e të tjera.

Tre aksidente në rajonin e Tikveshit, katër të lënduar rëndë

Kavadar, 23 prill - Tre aksidente kanë ndodhur gjatë fundjavës në rajonin e Tikveshit në të cilat janë lënduar katër persona. Prej tyre dy janë minoren. Zëdhënësi i SPB Veles, Verolub Dodevski informoi se dje kanë ndodhur dy aksidente dhe një të shtunën. "Dje rreth orës 15:00 në autostradën Negotinë - Veles në rreth 500 metra para pikës pagesore 'Gradsko', një automobil i udhëtarëve 'BMV X4' me targa të Shkupit i drejtuar nga G.G. (74) e kishte humbur kontrollin ndaj automobilit dhe kishte dalë nga rruga, ku lëndime trupore kanë marrë shoferi dhe bashkudhëtarja. Ata me automjet të Ndhimës së parë janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm Veles ku janë konstatuar lëndime të lehta trupore", deklaroi Dodevski. Të njëjtën ditë, në orën 20:00 në rrugën magjistrale Gradsko - Prilep ka ndodhur një aksident rrugor në të cilin janë lënduar dy minoren. Aksidenti ka ndodhur midis automobilit "Hjundai" me targa të Strugës, të drejtuar nga D.D. (61) dhe traktorit "IMT" me targa të Kavadarit nga R.R. (36) nga Rosomani. Lëndime të lehta trupore kanë marrë dy fëmijë të moshës 12-të dhe 15-të të cilët ishin në traktor. Ata janë dërguar në Spitalin komunal në Kavadar. Aksidenti i tretë ka ndodhur të shtunën rreth orës 15.30 në Negotinë në rrugën "Femo Kulakov" kur një automobil i udhëtarëve "mercedes" i drejtuar nga M.R. (26) është përplasur në një shtyllë druri nga rrjeti energjik ku është lënduar bashkudhëtar B.L. (26) të cilit i është dhënë ndihmë mjekësor në Spitalin e përgjithshëm në Negotinë.

65-VJETORI I THEMELIMIT TË IPSH-së

Vaksinimi nuk është kusht për regjistrim në shkolla

Shkup, 23 prill - Ministria e Shëndetësisë nuk do të kërkojë që vaksinimi të jetë kusht për regjistrim në shkolla. Zëvendësministri i Shëndetësisë, Coce Çakarovski, para fillimit të shënimtë të 65 vjetorit të themelimit të IPSH - Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët në Kozle, tha se e drejtë individuale është që çdo prind të vendos nëse do ta vaksinonjë fëmijën e saj, megjithatë si Ministri e Shëndetësisë duhet të mbajnë llogari për sigurinë kolektive, sepse siç theksoi një fëmijë i pavaksinuar, dhe i infektuar mund të jetë shkak për sëmundje infektive tek shumë fëmijë. "Në kontakt të përhershëm jemi me Ministrinë e



Arsimit, do t'i harmonizojmë qëndrimet. Nuk është saktë se punojmë në atë se fëmijët nuk do të regjistrohen në kopshte apo shkolla nëse nuk janë të vaksinuar. Do të punojmë në atë që prindërit që janë

skeptik, t'u themi se tek ata nuk duhet të ketë frikë se vaksinat nuk janë të sigurta", u shpreh Çakarovski. Ai potencoi se numër i madh i deputetëve e mbështesin këtë qëndrim se duhet të mbajnë llogari për

sigurinë kolektive respektivisht sigurinë kolektive tek fëmijët. "Ata ditëve të fundit dolën me deklaratë se gjithkund në vendet ku është zvogëluar përqindja e imunizimit duhet të punohet kundër atyre fushatave antivaksinale", shtoi Çakarovski. Drejtori i IPSH, Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët në Kozle, Angellço Andonovski tha se vaksinimi është segment i nevojshëm i një shoqërie, duhet të jetë kusht për regjistrim në shkollat she është vendosur në korniza ligjore. "Ulja më e madhe e shkallës së sëmundjeve që mund të parandalohen me vaksinë, ka ndodhur pas aplikimit të vaksinës së përsh-

tatshme", informoi Andonovski. Për vite me radhë, tha ai, Maqedonia ka një sistem të suksesshëm të imunizimit në vend krahas zbatimit nga shërbimet e vaksinimit në shtëpitë e shëndetit në vend. Për vite të tëra, ka pasur një mbulim të lartë imunizimi me të gjitha vaksinat. Rasti i fundit i difterisë është regjistruar në vitin 1976. Nuk ka të dhëna mbi rastet e regjistruara të tetanosit (tetanus) që nga viti 1993. Rasti i fundit i poliomiellit është regjistruar në vitin 1987, ndërkohë që në qershor 2002, Maqedonia së bashku me vendet e tjera është një nga vendet e liruar nga polio (polio free country). (D.K)

Zgjidhjen institucionet e shohin në vendosjen e sistemit të qëndrueshëm, me të cilin do të mundësohet që ushqimi tepricë nga prodhuesit, distributorët, tregtarët, objektet hotelierike dhe amvisëritë në mënyrë efikase të shpërndahet dhe dërgohet deri në vende të caktuara, ku qytetarët e rrezikuar socialë do të kenë qasje

Shkup, 23 prill - Shumë ushqim i hedhur në plehra, ndërsa shumë të uritur në Maqedoni. Si të bëhet sistem me të cilin ai në vend se në mbeturina të përfundojë te ata të cilëve më së shumti u nevojitet. Kuzhinat popullore nuk janë funksionale, shërbejnë numër të vogël të njerëzve, ndërsa kanë çmim të lartë të mirëmbajtjes, potencojnë organizatat civile, të cilat viteve të fundit punojnë për ballafaqim me këtë problem. Qëndrim me të cilin pajtohen edhe nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Zgjidhjen edhe të parët edhe të dytët e shohin në vendosjen e sistemit të qëndrueshëm, me të cilin do të mundësohet që ushqimi tepricë nga prodhuesit, distributorët, tregtarët, objektet hotelierike dhe amvisëritë në mënyrë efikase të shpërndahet dhe dërgohet deri në vende të caktuara, ku qytetarët e rrezikuar socialë do të kenë qasje.

Për këtë qëllim edhe Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale shpalli thirrje publike "ObrokZaSite", ku mund të paraqiten të gjitha kompanitë e interesuara mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe organizata civile, përmes të cilave me mjete financiare do të ndihmohet të realizohen zgjidhjet më inovative për sigurimin e ushqimit për qytetarët e varfër, të ofruara në thirrje. "ObrokZaSite" synon gjetjen e zgjidhjes inovative, sistematike dhe të qëndrueshme për sigurimin e ushqimit për personat dhe familjet me nevojë reale për përkrahje të bashkësisë. Me zgjidhjen do të mundësohet që ushqimi tepricë nga prodhuesit e ushqimit, distributorët, tregtarët, objektet hotelierike dhe amvisëritë që do të donin të bëhen pjesë e kësaj platforme, në mënyrë efikase të shpërndahet dhe dërgohet deri në vende të caktuara, ku qytetarët e rrezikuar socialë kanë qasje", tha Jovan Despotovski, drejtor i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik.

Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, vlerëson se kjo thirrje duhet të mundësojë të gjendet zgjidhje inovative që të sigurohet ushqim për të gjithë të cilëve u nevojitet. "Të mendojmë sistem që nënkupton grumbullimin e ushqimit të tepërt që mbetet

NË KËRKIM TË NJË ZGJIDHJE AFATGJATE

USHQIMI NË PLEHRA, NUK NDIHMOHEN TË URITURIT



dhe për momentin përfundon në mbeturina dhe të orientohet drejt qytetarëve për të cilët ky ushqim do të thotë shumë sepse jetojnë në varfëri", thotë Carovska.

Shumë organizata joqeveritare dhe civile punojnë në ballafaqim të këtij problemi. Por, të gjitha aksionet edhe pse janë të mirëseardhura janë individuale, në kohë të kufizuar në varësi të mjeteve për realizimin e projekteve, dhe gjithashtu me to përfshihen një numër i vogël i qytetarëve. Për këtë shkak forcat duhet të bashkohen, të vendoset bashkëpunim midis institucioneve shtetërore, pushtetit vendor organizatave civile me qëllim që ushqimi që hidhet të arrijë tek një numër i madh i qytetarëve të varfër. Dushko Hristov nga Banka për ushqim, organizata që shumë vite merret me këtë problematikë, thotë se është e mundur të vendoset sistem i mirë dhe se duhet të shfrytëzohen përvojat e këtyre vendeve në të cilat sisteme të ngjashme funksionojnë. Për këtë, thotë, nevojitet bashkëpunim i institucioneve shtetërore, pushtetit vendor dhe shoqatave civile, fushëveprimi i punës të së cilëve është pikërisht kjo fushë. Varfëria potencon, është në nivel lokal dhe në atë rural dhe kështu duhet të vepohet, sepse shumë nga këta të cilëve u nevojitet ushqim nuk munden apo nuk dinë si të vijnë deri te vendi ku ky do të ofrohet. Për këtë shkak duhet të bëhen përpjekje që ushqimi të silllet deri te to.

"Për momentin autoritetet pak i kanë hapur dyert që të mundemi t'u sugjerojmë si do të zgjidhej kjo. Në Maqedoni hidhet shumë ushqim. Ne kemi bërë hulumtime sa janë sasi të ushqimit që hidhen, sa pjesë nga ushqimi është i përditshëm, sepse jo i gjithë ushqimi që përfundon në hedhurina mund të

shfrytëzohet për familjet e rrezikuara sociale dhe qytetarët. Ata kanë treguar se në Maqedoni hidhet ushqim që mund të vendoset në sistem, vetëm ushqim që përfundon në Drislla, e cila është e vetme që mund të japë dokument për ushqim të anuluar apo të shkatërruar, mund të shërbejë 15 deri 16 mijë familje dhe si merret parasysh se një familje ka mesatarisht të paktën tre anëtarë kjo do të thoshte se me ushqimin mund t'u ndihmohet rreth 45 deri në 40 mijë njerëzve, të cilët në mënyrë të këtillë të donojnë të paktën një racion në ditë gjatë tërë vitit", thotë Hristov. Ai mendon se edhe pse deri më tani organizata të ndryshme dalin me numër prej 450.000 qytetarëve të cilët kanë vetëm një racion në ditë, ai numër nuk është i saktë dhe se shfrytëzohet për të treguar se situata në Maqedoni është alarmuese.

"Situata është e keqe, por jo në përmasa kaq të mëdha. Në Maqedoni kemi varfëri dhe uri, kjo nuk është kontestuese si organizatë kemi qenë në shumë shtëpi. Në gjysmën prej mbi 30 mijë shtëpive të këtyre familjeve nuk do të duhej të jetonte as një qen bile, sepse kushtet janë të atilla që nuk kanë as



MILLA CAROVSKA

Të mendojmë sistem që nënkupton grumbullimin e ushqimit të tepërt që mbetet dhe për momentin përfundon në mbeturina dhe të orientohet drejt qytetarëve për të cilët ky ushqim do të thotë shumë sepse jetojnë në varfëri

energji elektrike, as ujë, as frigorifer, ashtu që edhe nëse marrin ushqim nuk kanë ku ta ruajnë", thekson Hristov. Sipas tij, kontestuese është ajo që ekzistojnë shumë organizata civile të cilat punojnë në mënyrë të segmentuar në këtë çështje. Me këtë fragmentim, thotë bashkësia e biznesit do të duhet të jetë donator kryesor i ushqimit, duke filluar nga prodhuesit, distributorët, shitësit, gjendet në pozitë të palakmueshme sepse nuk di me kë të bashkëpunojë.

"Nuk ofrohet koncept që është i qëndrueshëm, por është nga karakteri i përkohshëm dhe shërben një numër të vogël të qytetarëve. Kompanitë dëshirojnë të ndihmojnë edhe një pjesë të prodhimeve të tyre t'i vendosin në funksion të të varfërve dhe të uriturve, por, kërkohet formë dhe mënyrë. Ushqimi që është afër skadimit për përdorim përmes rrjetit të organizatave në vend që të përfundojë në Drislla ose në deponi të tjera, duhet të distribuohet në nivel lokal tek ata që u është i nevojshëm. Në bazë të donacioneve dhe sponsorizimeve të tilla, kompanitë do të kenë përfitime sepse mund të bëjnë kthim prej pesë për qind të TVSH-së në pjesën e ushqimit të donuar", thekson ai.

Hristov potencon se do të ishte mirë në të ardhmen të mendohet që kompanitë donatore të kenë edhe një lloj tjetër të beneficionit, sepse ai për momentin është i limituar. Ne, thotë ai, do të tentojmë të ofrojmë edhe drejtime për krijimin e një sistemi të tillë, por deri në vendosjen e tij ushqimi do të duhet të distribuohet përmes të ashtuquajturave banka për ushqim. Hristov thotë se kuzhinat popullore janë joadekuate sepse mbulojnë vetëm një përqindje të vogël të të varfërve, përkatësisht rreth katër mijë njerëz. Problem shtesë, shton është ajo që ushqimi që ndahet nuk është cilësor.

"Nuk do të thotë se nëse dikush është i uritur duhet të hajë ushqim të tillë të keq dhe me çdo çmim të arsyetohemi se i kemi dhënë ndonjë ndihmë", thekson ai. Si një nga shembujt që mund të funksionojë, është në komunën e Qendrës. Kryetari i Komunës Sasha Bogdanoviq e potencoi sistemin e bankave për ushqim, diçka që të cilën veçmë punohet në komunë.

"Shpresoj se në periudhën më të shkurtë në bashkëpunim me të gjithë faktorët Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, sektori i biznesit, njerëzit të cilët prodhojnë dhe distribuojnë ushqim, por edhe të gjithë që duan të dhurojnë, do të mund të bëjmë sistem në të cilin në vend se të hidhet të silllet deri te ato të cilëve më së shumti u nevojitet", tha Bogdanoviq. Ai sqaroi se në Komunën e Qendrës veçmë është siguruar vend në hapësirat e Kuzhinës popullore, prej ku do të dorëzohet deri te shfrytëzuesit e ndihmës sociale por edhe deri te të gjithë të cilëve u nevojitet.

ÇDO BANOR KA BËRË NGA 379 KG MBETURINA

Gjatë vitit të fundit në Maqedoni është mbledhur 635.875 tonë mbeturina komunale, ndërsa sasia e mbeturinave të përgjithshme ka qenë 786.881 tonë, publikoi Enti Shtetëror i Statistikës. Sasia vjetore, ndërkaq, në mbeturina të krijuara komunale për banor në vitin 2017 është 379 kilogramë, që është 1.3 për qind më pak nga sasia e njëjtë në vitin 2016. Krahasuar me vitin 2016, sasia e përgjithshme të mbeturinave të të mbledhura komunale në vitin 2017 shënon rritje prej 4.2 për qind. Sasi më të madhe të mbeturinave të mbledhura komunale është shënuar në rajonin e Shkupit 164.246 tonë apo 25.8 për qind nga gjithsej sasia e mbledhur e përgjithshme në Republikën e Maqedonisë. Nga gjithsej sasia e

mbledhur e mbeturinave komunale, 527.700 tonë apo 83 për qind janë mbledhur nga amvisëritë, ndërsa 17 për qind nga persona fizikë dhe juridikë (mbeturina komerciale). Sipas llojeve të mbeturinave, sasi më të madhe të mbeturinave të mbledhura janë mbeturina të përziera komunale, 554.280 tonë apo 87.2 për qind, ndërsa më pak sasi të mbeturinave nga goma, 1.007 tonë apo 0,2 për qind nga sasia e përgjithshme e mbeturinave të mbledhura komunale. Sasia e përgjithshme e mbeturinave komunale për banor në vitin 2017 është 379 kilogramë, që është për 1.3 për qind më pak nga sasia e njëjtë në vitin 2016. Sasia më të madhe e mbeturinave të mbledhura komunale, gjegjësisht 99.4 për qind hidhet në deponi.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHALLJE PUBLIKE NUMËR – 31/2018

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komuna Sveti Nikolla “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndhimës udhëheqës I realizues(ë)
i sektorit për çështje normative - juridike,
përkrahje të Prefektit, tatime, zhvillim
ekonomik lokal dhe mbrojtje sociale

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike ose shkenca ekonomike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- të dhënë provimin e jurisprudence

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 31.331,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies I realizues(ë)
për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor,
Njësia për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit
jetësor, Sektori për urbanizëm, mbrojtje të
mjedisit jetësor, punë komunale dhe tjetërsim të
tokës ndërtimore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, Arkitekturë, Urbanizëm dhe planifikim dhe Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative

- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 28.302,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3. UPR0101V03000 Bashkëpunor për I realizues(ë)
përgatitje të projekteve për zhvillimin ekonomik
lokal, Njësia për arsim, sport, kulturë, zhvillim
ekonomik lokal, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të
fëmijëve, Sektori për çështje normative -
juridike, përkrahje të Prefektit, tatime, zhvillim
ekonomik lokal dhe mbrojtje sociale

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca ekonomike, shkenca juridike ose shkenca organizuese dhe menaxhim(menaxhment)
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 22.501,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4. UPR0101V03000 Bashkëpunor për I realizues(ë)
instalime makinerike dhe efikasitet energjetik,
Njësia për çështje komunale, Sektori për
urbanizëm, mbrojtje të mjedisit jetësor, punë
komunale dhe tjetërsim të tokës ndërtimore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Elektroteknikë ose Makineri
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore

- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 22.501,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

5. UPR0101V0400 Bashkëpunor i ri për I realizues(ë)
mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrë, Njësia
për urbanizëm dhe mbrojtje të ambientit jetësor,
Sektori për urbanizëm, mbrojtje të mjedisit
jetësor, punë komunale dhe tjetërsim të tokës
ndërtimore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, Arkitekturë, Urbanizëm dhe planifikim dhe Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 20.987,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë. Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Arifi edhe njëherë ka rikujtuar se me qeverinë paraprake nuk ka patur mirëkuptim për marrjen tetë autobusëve, ndërsa tani është shprehur e bindur se me një bashkëpunim në mes të komunës dhe pushtetit qendror, do të sigurohen autobusët

REALIZIMI I TRANSPORTI PUBLIK PA AFAT KOHOR

EDHE NJË PREMTIM PËR AUTOBUSËT E TETOVËS

32 shtetase të huaja ndalohen në Pollog

Tetovë, 23 prill - Sektori për punë të Brendshme në Tetovë edhe këtë vit vazhdon në kontinuitet me aktivitetet për zbulimin e shtetaseve të huaj, të cilët qëndrojnë dhe punojnë pa leje në rajon, ose qëndrojnë në kundërshtim me qëllimin, në fakt keqpërdorin qëndrimin turistik në shtetin tonë. "Gjatë tre muajve e gjysëm sa kanë kaluar, janë realizuar tetë kontrole aksione në objekte hotelerike, nga të cilat pesë nga rajoni më i gjerë i Tetovës dhe tre nga rajoni i Gostivarit, kryesisht në muajin janar. Në këto kontrole janë zbuluar 32 shtetase të huaja, më së shumti edhe atë 26 shtetase nga Republika e Shqipërisë, pastaj pesë shtetase nga republika e Serbisë, dhe 1 shtetase nga republika e Kosovës. Pjesa më e madhe e tyre, kanë qenë të angazhuara si këngëtare dhe valltare, të moshave të ndryshme edhe atë prej 19-35 vjet", njofton policia e Tetovës. Sipas policisë, shtetaset e huaja në numër të konsiderueshëm, kanë keqpërdorur qëndrimin turistik, kurse disa prej tyre edhe kanë punuar në mënyrë jolegale nëpër objekte, dhe pas arrestimit dhe ndalimit në SPB Tetovë, janë dorëzuar në Departamentin për krim ndërkufitarë, migracion, të huaj dhe riatëdhësim, për procedurë të mëtutjeshme. Në këtë periudhë, gjithashtu, në kontroll aksionet janë zbuluar edhe 24 shtetase të Republikës së Maqedonisë, të punësuar nëpër objekte si valltare, kamarierë dhe shërbime tjera hotelierike. (U.H)

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 prill - Pas protestave të ditës së premte, ku organizata joqeveritare protestuan për transportin publik, ka qenë vet kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, e cila është zotuar se transporti publik është prioritet i komunës që drejton ajo. Arifi theksoi se Tetova tashmë ka një ndërmarrje komunale për transportin publik dhe pritet që e njëjta të jetësohet në praktikë, por pa dhënë afatizime kohore. "Siç e dini, Tetova dikur ka pasur transport publik, por për fat të keq ajo ndërmarrje është shuar. Kemi një vendim të Këshillit për themelimin të ndërmarrjes publike dhe mendoj që sa më parë të arrijmë ta vendosim në funksion me të gjitha ato probleme që ka në fillimet e saja një ndërmarrje. Atë e kemi prioritet dhe qëllim tonë. Do të duhet pak kohë, por atë qytetarët do ta kenë", tha Arifi. Ajo edhe njëherë ka rikujtuar se me qeverinë paraprake nuk ka patur mirëkuptim për marrjen tetë autobusëve. "Me Qeverinë e kaluar nuk kemi hasur në mirëkuptim për kërkesat tona, por tash jam e bindur se me një bashkëpunim në mes të komunës dhe pushtetit qendror edhe me angazhim tonin më të madh, do të arrijmë t'ia dalim", sqaroi Arifi. Pikërisht mungesa



e transportit publik ka bërë që shumë qytetarë të përdorin automjete private edhe për pak punë që kanë në qytetet, përdërisa i tërë komunikacioni është përqendruar në pjesën qendrore të Tetovës, ku edhe jo rrallë herë ka shumë kaos në trafik. Mungesa e transportit publik deri më tash ndonëse është premtuar, megjithatë në praktikë nuk është riaktivizuar asnjëherë. Kjo ka bërë që në aktivistë dhe vullnetarë të Qendrës Loja, të organizojnë një protestë simbolike nga qendra deri tek Komuna e Tetovës për të rikujtuar autoritetet e komunës për mungesën e transportit. Ata kanë improvizuar një autobus dhe shenja komunikacioni për të dërguar mesazhin tek drejtuesit e Komunës së Tetovës. Në

ndërkohë, në Tetovë vazhdojnë të mungojnë korsitë e biçikletave. Drejtuesit e tyre hasin në shumë vështirësi si pasojë e kësaj mungese duke shfrytëzuar trotualet e këmbësorëve dhe rrugëve. Kryetarja Arifi tha se është duke u shqyrtuar mundësia që edhe në Tetovë për vozitësit e biçikletave të ketë subvencione ose mënyra të tjera të shfrytëzimit të tyre. Këto komente Arifi i ka bërë gjatë shënimit të Ditës së Planetit Tokë në Tetovë. "Tetova pa makina është një aktivitet që është menduar gjatë dhe është menduar që disa ditë në vit të organizohet një aktivitet i tillë, është hera e parë që në Tetovë shënohet ky aktivitet, janë të mbyllura disa prej akteve më të mëdha rrugore me qëllim që qytetarët ta shijojnë

më shumë hapësirën dhe të lëvizin me biçikleta. Dëshiroj të theksoj se në takimin e fundit të mbajtur me lidhjen e kryetarëve të komunave shqiptare që u mbajt në Prishtinë, u dakorduar që qytetet që janë pjesë e lidhjes të organizojnë minimum tre ditë pa makina në qytetet e tyre dhe Tetova atë ditë e shënon sot për herë të parë. Shpresoj që kjo të ndikoj më tepër që qytetarët të lëvizin në këmbë dhe të shfrytëzojnë këto ditë të bukura për të lëvizur pa makina", deklaroi kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi. Ajo sqaroi se këta aktivitetet do të praktikohen jo vetëm ditën e diel por në raste të ditëve ndërkombëtare ekologjike do të mbahen edhe gjatë ditës së javës kur ka më shumë ngarkesë të automjeteve.

Shkup, 32 aksidente me dy të vdekur

Shkup, 23 prill - Një këmbësor dhe një shofer kanë humbur jetën në dy nga gjithsej 32 aksidente të regjistruara gjatë fundjavës në rajonin SPB të Shkupit. Në 20 aksidente lëndime të lehta kanë marrë 23 persona, ndërsa në 10 është shkakuar dëm material. Nga MPB informojnë se gjatë fundjavës policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Nga trafiku janë përjashtuar 478 shoferë shoferë për shkak të drejtimit të automjetit në ndikim të alkoolit, 109 shoferë para se ta marrin të drejtën për drejtim të automjetit dhe 141 shoferë fillestarë, si dhe katër automjete teknikisht të parregullta, 110 automjete të paregjistruara dhe një automjet për mbingarkesë. Janë sanksionuar edhe shtatë këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën në dritë të kuqe. Janë hasur edhe 279 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Katër shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 14 shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, tre shoferë nuk kanë dhënë përparësi për kalim të këmbësorëve në vendkalime për këmbësorë, shtatë shoferë janë renditur në mënyrë të parregullt, një shofer nuk ka dhënë përparësi për parakalim, si dhe 11 për mosmbajtjen e kaskës për mbrojtje. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 132 automjete.

Protestë kundër deponisë rajonale në Debërcë

Ohër, 23 prill - Disa mijë banorë nga pothuajse të gjithë fshatrat nga Komuna e Debërcës kanë protestuar kundër ndërtimit të deponisë rajonale afër fshatit Godivje. Ata saktë në mesditë e bllokuan komunikacionin në rrugën magjistrale Ohër - Kërçovë afër fshatit Botun. Banorët e Debërcës dërguan paralajmërim se asnjëherë nuk do të lejojnë ndërtim të deponisë në komunën e tyre, duke theksuar se bëhet fjalë për mjedis të pastër ekologjik dhe jo të ndotur. "Kjo është protestë në të cilën dëshirojmë t'i plasojmë argumentet e vërteta sepse këtu nuk mund të ndërtohet deponi. Shpresojmë se kjo do ta stimulojë Qeverinë që të zhvillojë debat publik dhe t'i shqyrtojë vendimet e saj. Në qoftë se vazhdojnë qëllimet që deponia të jetë në Debërcë, do të vazhdojmë me protesta, por edhe aktivitetet të tjera si procedura juridike, madje edhe në nivel ndërkombëtar", deklaroi Jadranka Biban nga Trupi koordinues i Iniciativës qytetare për mbrojtje të Debërcës nga ndërtimi i deponisë rajonale. Në tubim u theksuan



argumentet se pse nuk do të lejohet ndërtim të deponisë në Godivje. Kryetari i Komunës së Debërcës, Zoran Nogaçeski deklaroi se as ai, e as Këshilli i komunës nuk kanë të drejtë të shfuqizojnë vendimin në referendumin e mbajtur në tetor. Banorët paralajmërojnë aktivitetet edhe më radikale si mosbindje qytetare dhe bllokim 24-orësh të komunikacionit në aksin Ohër - Kërçovë. Këshilli i Komunës së Debërcës paraprakisht me aklamacion e hodhi poshtë vendimin për dhënie leje për krijim të deponisë rajonale dhe infra-

strukturës së nevojshme për Rajonin planor jugperëndimor nga ana e Qeverisë së republikës së Maqedonisë. Nga Këshilli u prononcuan se janë të vendosur që të shkojnë deri në fund në qëllimin që Debërcë të mbetet mjedis i pastër ekologjik dhe i mbrojtur. Ekologjistët dhe opinioni profesional pothuajse janë të njëzëshëm në qëndrimet se do të ishte e gabuar që deponia të ndërtohet në një lokacion që është ekologjikisht jo i ndotur, ndërsa edhe më shumë në një lokalitet që bën pjesë në rajonin e shtratit të Liqenit të Ohrit.

Parti e re!?

Nga

Adelina MARKU



Me të dëgjuar e kam, ose për të qenë më e saktë, entuziastë themelues edhe më kanë qasur për mendim! ...Pra, me të kuptuar e kam se në rrugë janë edhe tre parti politike shqiptare të reja...! Dmth sipas esapit tim, pesë janë ekzistuese (apo gjashtë!), plus dhe tre, bëhen nëntë! Oh, sigurisht janë më shumë! Por, ç'mendim iu jap tek bisedojmë!? Jo shumë! Miqësisht jua shpalos instinktin tim fillestar ndaj idesë së tyre për themelimin e partisë së re tu alarmu se po gabojnë kështu me këtë lloj entuziazmi energjik, i cili përmban edhe vetullngryse, edhe gisht'tregues kryeneç, edhe fajësim e baltosje të tjetrit por megjithatë e mbi çdo gjë edhe një idealizëm për të bërë gjëra të mira për shqiptarët në Maqedoni! Pastaj kur kthehem në shtëpi, shaj veten për demberllëkun tim e të miqve të mij! Kaq vite bashkë e mos të kujtohem të bëjmë një parti politike!? Hmmm, ka të bëjë me kalkulimin racional, megjithatë!

Kur entuziastëve jua them mendimin, e mira asht se nuk të hidhërohen kur e dëgjojnë vëzhgimin tim, por edhe nuk bëzajnë më gjatë për të pyetur se përse iu kundërvihem me argumentat që iua shpalos. A thu, t'i kem shtyrë t'a rimendojnë e t'a shtresojnë sërish entuziazmin?! Hmmm, oj joooo! Kam përshtypjen se çdo racionalizim të entuziazmit të tyre në atë çast – nuk duan t'a pranojnë! Legjitime a! Në këtë moment ndodh dhe ndarja, apo! Miqësore, -po shtoj! Shpresoj miqësore, -po shtoj edhe këtë! Nejse... Por çka flet fenomeni i krijimit të vazhdueshëm të partive politike shqiptare këtu në Maqedoni? Një analizë tregon për dy faktorë nxitës që bijnë në jetën paralele e të vazhdueshme të dy lloj emocioneve: pakënaqësinë vetëgjeneruese dhe e dyta forcën për krijim (psh. të një formacioni të ri). Faktorët nxitës të emocioneve janë poaq të lidhura me pakënaqësinë e përbrenduar tanimë! Kur këta dy emocione ndërveprojnë, dalin të jenë thika-thik ndaj njëna tjetrës. Sepse kur vetëgjeneron pakënaqësi, forcën për krijim e sh'ndron në pakënaqësi të serishme! Kështu ripërsëriten ciklet patetike të pakënaqësisë së vazhdueshme! Biles, në vazhdimësi e me posesivitet të theksuar "për" e "ndaj" Pakënaqësin(s)ë! Sikur da(ë)shu(i)rojmë të pakënaqemi! Të gjith' ngulun pingul në rrethet e pakënaqësisë! Edhe kur pimë çaj ne flasim për pakënaqësi. Edhe kur kafe, pakënaqësi! Edhe kur në xhami për

t'u falur ne flasim me pakënaqësi. Edhe nw shkollë e universitet, me pakënaqësi. Edhe kur anëtar partie në pushtet, ne flasim me pakënaqësi! Por, se sa brenda vetes këto formacione të reja politike, PAKËNAQËSINË dinë ose sa duan t'a shndërrojnë në Aftësi për Ndryshim, kjo është temë për t'u vënë në diskutim e vetëmbarsur. Ne bëhemi radikalë përmes vijës së thellë të pakënaqësisë tuj qenë të paaftë të përmbushim idenë e qëllimin! (prandaj të gjitha partitë, të rejtat ose të vjetrat, kanë po të njëjtën ideologji -rezultat pakënaqësie, e po të njëjtin program politik!)

Në esencë ndryshimi kërkon një gjë: AFTËSINË PËR TË REALIZUAR, për të PËRMBUSHUR QËLLIM! Të gjithë faktorët që sjellin deri tek krijimi i një formacioni të ri politik, janë pikërisht ato arsye rrethanoze që nevojiten të shërbejnë si Forcë për Ndryshim! Në esencë, formacionet e reja priten të krijohen jo si rezultat pakënaqësie, por si forcë për të krijuar politika që përmbushin jetën e njeriut me vlera ekonomike e të lirisë së veprimt. E quaj unë këtë moderim force krijimi e madje shkëputje nga motivet e së kaluarës që tërheq teposhtë! Megjithatë, historia jonë më e re e organizimit politik, vazhdon të zhvil-

lohet përmes një linje të simuluar të pakënaqësisë. Është një simulakrum ky që krijohet brenda partisë dhe posesiviteti për të braktisur simulakrumin, nxit idenë për krijim të një partie të re! Nuk e kam të plotësisht të qartë se përse është aq e vështirë të reformohen partitë e vjetra! Jo jo, nuk dua të përqesh me cinizëm i nderuar lexues, sepse gjendja jonë tanimë është e rrëndë e prandaj vazhdimisht përçarëse! E përçarja nuk krijon liberalizim e veprimt, por një liberalizim të përsëritshëm të pakënaqësisë. Sillemi thellbësisht rrethete të pakënaqësisë. Pra, ose ose totalitarizmi i lidshiptit kap nivel patologjik, vulgar, dhe eliminues ose ose mosprezenca e kulturës transformative përbrenda është indikacion i mjaftueshëm se partitë tona nuk kanë sistem e nuk e kuptojnë funksionalitetin përmes sistemit. Është e thjeshtë, sistemi në parti thjesht bazohet në aftësinë për veprim të moderuar, aftësinë për solidaritet dhe aftësinë për inkluzivitet! Flasim për centrifugim emocionesh e jo për centripetim nga orbita e fuqisë e vendim-marrjes! Kur ndodh e kundërta, këtu e kështu gjenerohet dhe efekti i keq e vetëluftues! Pra, ndodh dalja nga partia e vjetër e katapultimi në një for-

Entuziastët e ndryshimit nevojiten brenda partive politike, ato janë katalizatorët dhe gjeneruesit e ideve të reja...çdo periferim i tyre e rëndon partinë, e ngrys, e bën monolite, bajate, luftënxitëse! Ndërsa NDËRVEPRIMI është art i së mundshmes në një parti politike! Ai formacioni i ri politik që mbarset përmes forcës së ndërveprimit, ka shansin të sfidojë veten...çdo gjë tjetër është farsë, pakënaqësi dhe prandaj-demagogji!



macion të ri, të sapokrijuar! Gjithmonë e përherë faktori psikologjik ka shumë rrëndësi, sepse kjo ndjenjë e pakënaqësisë së vazhdueshme e vendos frustrimin si pararojë veprimi, e kjo pavetëdijshëm krijon blloqe, kufizon energjinë dhe inhibon komunikimin strategjik! Hmmm, pastaj gjen veten tuj përsërit gabimin e formacionit të vjetër ku ishe! Në anën tjetër, le të analizojmë se sa janë aftësitë fizike për të Përmbushur Ndryshimin e në përkthim kjo ka të bëjë me faktorin numër. Nëse ky numër përmbushet nga po të njëjtët njerëz që kalojnë nga një formacion në tjetrin/ose nëse ky formacioni i ri mbush kapacitetin e vetë me resurse të reja? Në të shumtën e rasteve përgjigja qëndron tek kalimi i njerëzve të njëjtë nga një parti (formacion) në tjetrën dhe ky kalim në të vërtetë nuk duhet lexuar si motivacion për ndryshim, por vetëm si grumbullim i ri i pakënaqësisë tanimë i zhvendosur fizikisht në një forum të ri. Të krijosh një nivel të ri të performancës politike do të thotë të kesh aftësinë të nxitësh një rini të tanë me u kyç në radhët e tua. Tjetër është ambicia e tjetër flet përditshmëria. Statistikat flasin për një korridor të ri të grumbullimit të të rinjve e po aq produkt i pakënaqësisë!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e hënë 23 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Ky korridor këta të rinj nuk i vendos(kanalizon) nëpër këto formacione të reja politike, por i katapulton jashtë shtetit! Atëherë si të ushqehen kapacitetet e partive të reja politike që synojnë të bëjnë ndryshimin (ose atë që partitë e vjetra nuk arritën t'a bëjnë)? Kush do bëjë inovacionin e kreativitetin politik? Faktori i tretë e me rëndësi për formacionin e ri politik në krijim është faktori kohë! Ndërsa koha kapet e organizohet kur me pjekuri sh'ndrohen në politika produktive kontekstet e përditshmërisë së votuesit! Do më mjaftonte të përmendja tre politika aktuale të cilat kërkojnë veprim në kohë e në çast: politikën bujqësore, politikën ambientale dhe politikën e "brain gain versus brain drain" (e të rrinjve). Asnjëherë, e jam tuj kap dekadën e pestë të jetës sime, nuk kam dëgjuar ndonjëri nga deputetët tanë të flasë për politikën bujqësore (e jo përmes pakënaqësisë populiste mbi agrarin), ose të flasë për politikën ambientale (e jo për pakënaqësisë populiste mbi deponitë) ose të flasë për politikën e kthimit të të rinjve në vend e që do thoshte, politika të krijimit të vendeve të reja të punës jashtë administratës shtetërore. E së fundmi po numëroj edhe një faktor të rëndësishëm për jetën e partisë së re politike, e ky është faktori PARA, resurset financiare. Jetojmë në një epokë të digjitalizimit të shpejtë, i cili vazhdimisht të imponon rritëm lodhës! Paratë janë të nevojshme jo për ditën kur votohet e kur partitë korruptojnë votuesin, por paratë janë të nevojshme për të ndërtuar komunikim me votuesin, për të dizajnuar politika financiare që garantojnë ekonomi të mirë, ...paratë janë të nevojshme për angazhim ekspertësh në parti që do shtronin rrugën me hapa pasa hapash e jo me rrena kapërcimesh e galopimesh populiste.

Ndërsa GJITHFAKTORI përmbledhës i këtyre më lartë ka të bëjë me Liderin / Lideren! Ky/kjo nevojitet të llogarisë mirë rreziqet dhe përparësitë e faktorëve më lartë: atë psikologjikun, fizikun, kohën dhe resurset! Kjo matje është kapital për formacionin e ri politik e jo vetëm emocion! I dyti, emocional i ose idealisti shpejt mund të prodhojë dështimin dhe liderin/lideren t'a vetëizolojë. "Vetëizolimi duhet shikuar nga këndi i ngecjeve në zhvillimin e gjithanshëm të një populli, të shtetit, të institucioneve dhe të faktorëve të tjerë që janë promotorë të progresit. Njeriu bëhet introvert kur nuk arrin të përballojë NDËRVEPRIMIN. Ai/ajo izolohet duke prodhuar parime të kota nga frika e dështimit. Fatkeqësisë më e madhe për liderin/lideren është humbja e diçkasë që e do me thellësinë e qenies...prurjen e ndryshimit dhe të mirës së përgjithshme! Izolimi dhe vetëizolimi janë si enët e lidhura në kimi, njëra prodhon tjetrën"- ("A. Xhaferi në kërkim të kuptimit", fq 47, . E. Robelli)

Prandaj entuziastët e ndryshimit nevojiten brenda partive politike, ato janë katalizatorët dhe gjeneruesit e ideve të reja ...çdo periferim i tyre e rëndon partinë, e ngrys, e bën monolite, bajate, luftënxitëse! Ndërsa NDËRVEPRIMI është art i së mundshmes në një parti politike! Ai formacion i ri politik që mbarset përmes forcës së ndërveprimit, ka shansin të sfidojë veten ...çdo gjë tjetër është farsë, pakënaqësi dhe prandaj - demagogji!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA

Surpriza e hidhur e Macron për Ballkanin

Nga
Ivan KRASDEV



Fjalimi i Emmanuel Macron në Parlamentin Europian ishte krisma e parë për hapjen e fushatës zgjedhore europiane në vitin 2019. Pasi dëgjuam fjalimin e bukur, nuk e dimë akoma, nëse presidenti francez do të tentojë në Europë atë që kërkonte në Francë para një viti – shkatërrimin e partive politike ekzistuese dhe krijimin e një platforme të re proeuropiane, thelbi i së cilës është refuzimi i statuskuosë. A do të rrezikojë ai t'i sfidojë aq shumë partitë e qendrës, që shumica qeverisin në Europë, sa që të ndahet edhe nga kancelarja Merkel? Si do të veprojë ai me rritjen e tensioneve mes Lindjes dhe Perëndimit? Si do ta sjellë ai energjinë e re demokratike në projektin europian, veçanërisht, në ato shoqëri, që fjalimet e tij i lexojnë në versione të përkthyer?

Prej shekujsh ka një lidhje të thellë në Francë mes politikës dhe poezisë - dhe Emmanuel Macron i mbetet kësaj lidhjeje besnik. Ai e vuri në provë edhe talentin e tij për dramaturgjinë, kur foli, për "luftën e re qytetare" në Europë, rreziqet e nacionalizmit dhe kur deklaroi se nuk do të jetë pjesë e një "gjeneratë sonambulësh". Ai i ngacmoi kundërshtarët politikë në anën e djathtë të spektrit politik në Europë, kur u pozicionua si mbrojtës i vlerave europiane, jo vetëm ndaj sundimtarëve autoritarë në Rusi, Kinë, Turqi, por edhe kundër "iliberaleve" në shtëpinë e vet, Europë, kujtojmë Hungarinë, Poloninë.

Macron fitoi pikë me pragmatizmin politik, kur u distancua nga narrativi klasik federalist, të cilin e mbështesin shumica e francezëve dhe nuk argumentoi më për "Shtetet e Bashkuara të Europës", por për një tatim digjital të përbashkët, që do ta forconte Brukselin.

Presidenti francez ka vendosur të jetë në rolin e vizionarit të kujdesshëm. Ai vetëm i rivijëzon opsionet politike të tij, në vend që t'i trumbetojë me të madhe. Nga ana retorike fjalimi ishte shumë i fuqishëm, por të bien në sy temat që nuk preku

Macron. Presidenti francez qëndroi dyshueshëm i heshtur, në temën e reformave në Eurozonë, që ishte lajtmotivi i fjalimit në Sorbonë vitin e kaluar. Heshtja është një sinjal i qartë për vështirësitë në bisedimet francezo-gjermane për unionin monetar europian. Ai gati nuk e preku qëndrimin e Europës në tregtinë e lirë, dhe nuk mbajti një qëndrim të qartë politik në temën e migracionit në Europë.

Gjenerali Charles de Gaulle një herë ka thënë: "Një lider i vërtetë e mban gjithmonë të fshehur asin nën mëngë, e i jep me të publikut një gjendje entuziazmi dhe emocion." Asi që kishte Macron ishte mesazhi i tij për të ardhmen e zgjerimit. "Nuk dua që Ballkani të drejtohet nga Turqia apo Rusia", tha presidenti francez në Strasburg. Por ai as nuk do një Europë me 28 anëtarë, së shpejti 27, që funksionon me vështirësi e që pastaj do të vendoste të "marrë galop me 30 apo 32 anëtarë por me të njëjtat rregulla". Ka një të vërtetë këtu. Shumica e europianëve do t'i jepnin të drejtë, se nuk ka kuptim të flitet për zgjerimin, kur nuk është vendosur se çfarë do që të jetë ky union, që do të zgjerohet. Aktualisht nuk ka asnjë miratim për një formë të re zgjerimi, pavarësisht nëse bëhet fjalë për Ballkanin, Turqinë apo Ukrainën. Nëse i pyet zgjedhësit europianë se sa e madhe duhet të jetë BE në të ardhmen, shumë do të zgjidhnin zvogëlimin, jo zgjerimin.

Por efekti konkret i mesazhit të Macron është katastrofik. Konstatimi i Jean-Claude Junckerit se alternativa tjetër e integritit në BE është një luftë në rajon është një shembull se si banaliteti mund të përdoret për shpëtim. Por në të vërtetë mesazhi Macron mban brenda fuqi shpërthyesë, përkë

Mesazhi i presidentit francez, Emmanuel Macron në Strasburg para disa ditësh ka fuqinë shpërthyesë të ashpërsimit të krizës në Ballkan. Ai dobëson madje edhe pozicionin e BE në rajon



qësim të gjendjes në rajon. Bullgaria, si presidente e radhës në BE ka të drejtë të akuzojë Macron, se për shkak të tij, samiti i përgatitur me aq kujdes në maj të tingëllojë më shumë si një shaka. Komisioni Europian po ashtu ka të drejtë ta interpretojë mesazhin e Macron si thikë pas shpine. Edhe reformuesit proeuropianë në rajon kanë të drejtë të akuzojnë Macron se po minon pozicionin e tyre.

"Ambiguitet konstruktiv" - ka qenë strategjia e preferuar e BE në mënyrën e sjelljes me Ballkanin. Kur bëhet fjalë për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, politikanët e BE thonë më dëshirë, pyetja e vetme që shtrohet është "kur". Por në realitet

askush nuk e beson, as në Bruksel e as në Beograd, se në vitin 2025 njëri nga këto vende do të jetë anëtar i BE. Por nëse deri tani loja e BE me Ballkanin quhej "mbajtja e derës hapur", Macron ka vendosur të mbajë dyert mbyllur, të paktën për momentin. Për këtë nuk mund ta akuzosh. Por ajo që mund t'i thuash është se me "ngrirjen" e zgjerimit të BE pa një strategji alternative, ai kontribuon në thellimin e krizës në Ballkan dhe dobëson pozicionin e BE në rajon. Ajo që u bë e qartë: Kur Macron flet për "europianët", elektorati, të cilin ai i drejtohet është vërtetë vetëm ai europianperëndimor.

(Ivan Krastev është drejtues i Qendrës për Strategji Liberale në Sofje, i Ftuar i Institutit për Shkencat Humane në Vjenë, dhe i Ftuar i bursës Richard von Weizsäcker i Akademisë Bosch në Berlin. Ai shkruan rregullisht analiza për New York Times. Libri i tij "Perëndimi i Europës" u botua në vitin 2017 në shtëpinë botuese Suhrkamp)

KATËRMBËDHJETË MINUTA, GJER TEK PËRJETËSIA



Pikërisht në ato çaste, Mario Vargas Llosës iu kujtua ai gusht i largët i jetës së tij rinore, kur nuk dinte nëse do të bëhej avokat apo shkrimtar, Veçse e dinte shumë mirë, qysh atëhere, se edhe nëse i duhej të jetonte fare pa para, do të organizonte në atë mënyrë jetën e tij, që t'i krijonte mundësinë vetvetes t'i përkushtohej totalisht letërsisë. Ose, të paktën, t'i kushtonte asaj shumicën e kohës dhe energjisë, që kishte në dispozicion. Prej atij gushti e mandej, e mbante mend veten të kërkonte gjithëherë punëra të tilla, që, mbi të gjitha, t'i jepnin mundësi për një gjë: të kishte kohë dhe energji të shkruante.

Kishte zakonet e shumicës së shkrimtarëve në botë: ngriheshe herët në mëngjes, aty nga ora pesë, për të bërë punën e tij më të dashur, të shkruante ose të lexonte. Kështu dhe atë ditë. Ndonëse kishte disa javë që jetonte në Nju Jork, e kishte marrë të përditshmen me vete. Që të mos zgjonte të shoqen, Patrician, kishte bërë kafënë e preferuar dhe ishte ulur për të lexuar. Veçse ajo ditë nuk ishte si çdo ditë.

Ishte pikërisht dita kur shkrimtari peruvian Mario Vargas Llosa do të fitonte "Nobelin".

I rrëfhet Llosa "El Pais"-it:

"Një çast ndjeva prezencën e Patricias në sallon. M'u afrua me telefonin në dorë dhe me një shprehje të fytyrës, që më trembi. Ndonjë tragjedi familjare, mendova. Kapa receptorin dhe brenda ca zhurmave të çuditshme, si të vinin nga funddheu, dëgjova një zë të më fliste në anglisht. As që munda të dalloj fjalët "Akademia Suedeze" dhe linja u ndërpre. Mbetëm të heshtur, duke parë njeri tjetrin, pa mundur të shkëm-

"Pikërisht në gjashtë të mëngjesit, radioja, televizioni dhe interneti vërtetuan që lajmi për "Nobelin" e letërsisë ishte i saktë.

Siç kishte parashikuar Patricia, shtëpia u pushtua prej kaosit dhe nga ai moment pushova të mendoj, çaste-çaste edhe të frymëmarr".

MARIO VARGAS LLOSA

"Le Monde"

bejmë dy fjalë, deri sa telefoni filloi të bjerë përsëri. Kësaj here zëri arriti i qartë. Zotëria nga ana tjetër e linjës tha se ishte sekretari i Akademisë Suedeze, se më ishte akorduar Nobeli letrar dhe se lajmi do të bëhej publik pas katërmëdhjetë minutash. Do të mundja ta dëgjoja në televizion, në radio dhe në internet".

Pikërisht për këto katërmëdhjetëminuta, për kohën që barazohej me një jetë të tërë të trazuar shkrimtari, u bë nami në median e përbotshme. Por "El Pais"-i, organi i dashur i shkrimtarëve spanjofolës të të gjithë planetit, kishte "vizën" e duhur prej shkrimtarit për t'i publikuar i pari.

... Atëhere Patricia tha se duhej të njoftonin menjëherë Alvaron, Gonzalon dhe Morganën, tre fëmijët e tyre. Për të zonzjen e shtëpisë, para së gjithash gëzimi ishte familjar. Llosa, i vetëpërbajturi prej natyre, propozoi që të prisnin të kalonin ato katërmëdhjetë minutat, gjersa lajmi të bëhej publik. Dhe i kujtoi së shoqes atë shakanë e hidhur, që i kishin bërë dikur në Romë Alberto Moravias, kur disa miq, ose më mirë armiq, i kishin stisur një farsë të poshtëre. E kishin lajmëruar telefonikisht, gjoja nga Akademia Suedeze, se kishte fituar Çmimin Nobel dhe shkrimtari, në gëzim e sipër, e kishte përcjellur lajmin në tërë shtypin e Apenine-

ve. Se ç'ndodhi mandej me Moravinë, Llosa nuk donte edhe vetëm ta kujtonte, jo më të përsëritej për atë vetë.

"Nëqoftëse është e vërtetë do të përmbysim shtëpinë, do bëhet nami, - pranoi Patricia propozimin e urtë të të shoqit dhe shtoi: - Më mirë, ndërkohë, të bësh një dush..."

Ç'dush?! Llosa ishte qullur i tëri nga emocionet dhe agonia. Shkoi para dritares së sallonit dhe ndërësa kishte filluar të bënte prezencën e tij agu njujorkez, kishte filluar të bënte mendime të ndryshme.

I referohemi përsëri "El Pais"-it:

"Kujtova shtëpinë në Kocaba, ku kalova vitet e fëmijërisë dhe librin që më kishte stigmatizuar, "Njëzetë poezi erotike" të Nerudës. Këtë libër ma kishte ndaluar nëna ime ta lexoja. Kështu kishin bërë të gjithë prindërit e familjeve "që nderonin vetveten". E kisha fshehur në komodinën time dhe e lexoja herë pas here. Ishte libri i parë i ndaluar që lexoja..."

Kujtova hundën e madhe dhe kokën tullace të gjyshit tim, Pedro, që shkruante vargje gjatë festave dhe i shpjegonte familjes arsyen, pse unë ndonjëherë refuzoja të haja: "Për poetin gjella është prozë".

Llosa kujton se i kishte ardhur nëpër mendje, gjatë atyre

katërmëdhjetë minutave të ankthit, xhaxhai i tij, Luko, që shkruante dhe botonte historira të vogla, duke u bërë shkrimtari i parë që adhuronte nga afër. Paskëtaj, kujtoi historitë e tij të para. Kujtoi atyre minutave edhe miqtë e tij, Luko Lojaza dhe Abelardo Okuento, si edhe periodikun e tyre "Literatura". Kishin mundur të nxirrnin tre numra vetëm. Të asaj kohe ishin edhe betejat e ashpra midis tyre, për t'i dhënë përparësinë Borhesit apo Sartrit...

"Unë mbroja të dytin, kurse ata të parin dhe, doemos, kishin të drejtë. Kështu më kishte mbetur nofka, pas së cilës duhet të them se isha dashuruar, "Sartri i vogël".

Ndërsa katërmëdhjetëminutëshit të agonisë po i vinte fundi, Llosa kujtoi konkursin e "Revue Francaise", të vitit 1957, të cilin e kishte fituar ai vetë, shkrimtari i ri peruvian, me tregimin "Provokimi". Mban mend me nostalgji, se i kishin bërë dhuratë një udhëtim njëmuor në Paris, ku kishte bujtur në Hotelin "Napoleon", atje ku kishte patur fatin të njihet dhe të bisedonte me Alber Kamy-në dhe Maria Sezares-in.

Së fundi, Llosa kishte kujtuar përpjekjet e dëshpëruara, për t'u pranuar në një takim tek për tek nga idhulli i tij, Zhan Pol Sartri, qoftë edhe për një minutë, "për t'i parë nga afër fytyrën dhe për t'i shtrënguar dorën".

Nuk ia kishte arritur. Sartri dhe

e shoqja, Simon de Buavar, në krye të inteligjencës pariziane të kohës, rrethuar nga ajo aureolë e jashtëzakonshme lavdie dhe krenarie, nuk mund të harxhonin kohën e tyre të vyer për një djalosh të ardhur nga Amerika Latine. Qoftë edhe fitues i një konkursi të parizianes "Revue Francaise".

Ku ta dinin ata, se pas kaq e kaq vitesh, djaloshi në fjalë, Mario Vargas Llosa, do të hypte në fronin letrar të Akademisë Suedeze dhe do të merrte në dorëzim "Nobelin"-2010-të të letrave...

Thua ta kishte parashikuar këtë fat të mëvonshëm mendja gjeniale, njëkohësisht surrealiste, e Sartrit? Domethënë, që djaloshi peruvian Llosa, i cili këmbëngulte pa kortezi të kalonte, qoftë edhe për disa minuta, pragun e familjes Sartr në Paris, do të kalonte një ditë portën e rëndë të Akademisë Suedeze, për të mbetur përgjithmonë atje?

Në është kështu, kjo duhet ta kishte marrë në qafë Llosën e atëherëshëm. Sartri vetë, nuk kishte pranuar asokohe të kalonte atë prag të famshëm dhe të shumë-lakmuar prej të tjerëve, në Suedinë e afërme, për të marrë në dorëzim "Nobelin" që i kishin akorduar. Kishte thënë asokohe justifikimin e famshëm: "Ky Çmim bën çështje e mundur të shpërbëjë një shkrimtar..." Dhe nuk kishte shkuar për ta marrë...

O zot! Diku gjetkë kam lexuar, se një nobelist tjetër, ka thënë: "Pas Nobelit nuk kam bërë asgjë me vlerë!"

Thua?!


Kjo nuk duhej t'i ketë rënë në mendje Mario Vargas Llosës, gjatë atyre katërmëdhjetë minutave, që iu deshën për të aritur gjer tek përjetësia.

GRIGOR JOVANI
Athinë, tetor 2010

Këtë libër ia kushtoj me mirënjohje dhe mall Martin, mësuesit dhe mikut". Botimi i ri i Hans Joachim Lanksch nis me këtë përkushtim, pas titullit, "Martin Camaj, i pazbuluem". Iu drejtohet atyre që në ardhmen do e lexojnë librin e tij me këto fjalë: I dashun lexues, e dashun lexuese, libri që po e hap nuk përmban studime shkencore për Martin Camajn

Fatmira NIKOLLI

NJI ÇAJ ME MARTIN CAMAJN E KUJTIMET E MBRËMJEVE BAVAREZE



Studimet dhe punimet shkencore për një shkrimtar zakonisht janë të thata teorike e të shkrueme nga një shkencëtar për shkencëtarë të tjerë, jo për publikun lexues. Me shkrimet e mia të thjeshta dhe modeste synoj vetëm me ta afrue poezinë dhe figurën e Martin Camajt.

Tekstet e këtij libri i kam shkruar në rrjedhën e vjetëve me raste të ndryshme. I kam shkruar me dashuni për poetin tim të preferuem e ma të dashtun të letërsisë shqipe. Vargjet e Martinit "janë për t'i lexue në heshtje" e kërkojnë një lexim të përqendruem...

Mbas këtij sqarimi paraprak, në librin me titull "Martin Camaj ende i pazbuluem", Hans Joachim Lanksch bën me dije që në krye të herës se personi i Martin Camajt ishte i qetë, paksa timid, i padukë e modest, me plot dinjitet dhe krenari të natyrshme, shpesh ishte ndërlyzash, e kërkonte vetminë. Nga ana tjetër, i njëjti Martin Camaj, djalë bariu nga katundi mbishkodran Temal, e çau rrugën e vet me energji dhe vullnet të rrallë.

DROMCA KUJTIMESH NGA ISH-STUDENTI

Autori i këtyre rreshtave, si student, kishte fatin e bardhë me mësues shqipen nga Martin Camaj. Nji ditë prej ditësh, gjatë pushimit dhetëminutash mes dy kursesh, tue u shëtiti në korridor para auditorit dhe tue bisedue për çkamos, profesori e pyeti studentin—me çka merreni në kohën e ngesë? Kur ky tha se me përkthimin e poezisë, Martin Camaj tha — punë interesante. Mbas nji pauze shtoi, me zâ të ulët—unë shkruaj. Mbas nji pauze tjetër, studentit të shastisun i tha —jam shkrimtar shqiptar.

Martin Camaj ishte bashkëbisedues për mrekulli. Në radhë të parë, ai dinte ende artin pothuaj të shuem me ia vû veshin tjetrit. Nuk mbahej si profesor, por si mik. Për hallet personale të studentëve e bashkëpunëtorëve shpesh kërkohet këshilla e tij.

Ai ishte nji qenie rebeluese që i çmonte traditat, vërtet, dhe nuk i duronte konvencionet. Martin Camaj nuk iu përgjigj shabllonit për

"emigranti". Kishte sipas Lankschit, nji qëndrim bukur të kjtartë rreth komunizmit, por nuk ishte i mbrujtun nga konservatorizmi syplasun siç donin qarqe të përcaktueme me e paraqitë atë. Nuk birte kohë, si ca e ca të tjerë, me të shkruemet e shkrimeve aq të flakta sa dhe të kota për punë politike e patriotike. Simbas bindjes së tij "nuk jam njeri i politikës, por jam njeri politik", u rrinte larg grupimeve, rrymave e partive politike të mërgatës. Lanksch kujton se Camaj, nuk andërronte për Shqipninë e Madhe, as për Mbretninë e Shqipnisë dhe as për zbarkime parashutistash. Vetëm kah fundi i jetës, i lodhun nga përjetimi shumëdekadash i sundimit të paligjshmënisë si në Shqipni ashtu dhe në Kosovë, shpresonte fort te forcat politike që vetes ia vunë emnin "demokrat" dhe atyne u sinjalizonte simpati. Camaj nuk ishte i detyruem të shihte se çfarë kishte me u bâ mâ vonë nga këto forca dhe përçapjet e tyne politike —mbas rrezimit zyrtar të monizmit u shue jeta e tij mu në kohë kur viheshin filizat e para të reja mbas regjimit i cili e kishte bâ Camajn me e lëshue vendin e vet amë.

Shton se jo vetëm në lidhje me poezinë "rurale" Martin Camajt i janë ngjitë epitete, etikete dhe kli-she nga mâ të ndryshmet e të pavërteta.

NË DHOMËN E CAMAJT

Lanksch kujton në librin e tij, "Martin Camaj ende i pazbuluem" se në dhomën e tij të punës, në tryezën e shkrimit, Martin Camaj kishte nji koleksion të madh breshkash, në të gjitha trajtat, ngjyrat dhe materialet. I donte breshkat dhe fliste me shumë qejf për punë breshkash ku theksoi ndjeshmëninë e tyne të hollë me të cilën i parandjejnë shkundullimat. Deri diku, me natyrën e tij paqësore që nuk ishte në gjendje me ia bâ ndonji të keqe kurrkuj, me nji rra-shtë të fortë që mbronte ndje-

shmëninë e tij të jashtëzakonshme prej lëndimesh nga jashtë, njeriu Camaj i ngjante kafshës së tij mâ të preferueme, breshkës.

Në atë kohë të miqësisë me Martin Camajn, vetë Lankschi kishte nji qen pekinez. Qeni e donte shumë profesorin dhe ky sillej bukur me qenin, por disi i rezervuem. Nji ditë i tregoi psenë. Si djalë i vogël, ai kishte nji shok të vërtetë, nji qen ujk. Tanë kohën e kalonte me qenin, madje tue kalëru mbi të. Nji mëngjes prej mëngjesëve, qeni nuk ishte. Martini shkoi me e kërkue qenin dhe e gjeti te prroni, të shqyem e të copëtuem prej ujquve. Uji i prronit ishte i kuq. Prej asaj dite, Martini nuk ishte mâ në gjendje me dashtë nji qen.

Vjet me radhë, gjatë periudhës së semestrit universitar, mbas ligjeratave të tij, Martin Camaj shkante në banesën e Lankschit afër universitetit, pinin çaj dhe bisedonin për punë letërsiet në përgjithësi dhe për poezitë e tij në veçantí. Gjatë gjithë këtyne vjetëve, Lanksch thotë, se kurrë s'ka dëgjuar as edhe nji fjalë të ashpër prej tij. Kur kishte nji vërejtje për përkthimin që Lankschi u kishte bërë poezive të tij, nuk e thoshte vrazhdë por me shumë delikatesë. "Edhe gjermanisht due me qenë Camaj, jo Camaj me kapelë bavareze", tha.

Ishte pothuaj e pamujtun shton, me pasë sherr me Martin Camajn. I vetmi njeri me të cilin grindej ishte miku i tij mâ i ngushtë, Arshi Pipa. Ata të dy dijshin me u grindë, gjithnji vetëm për nji temë të vetme, për përziemjen e Pipës të punëve letrare me politikën.

Shpesh çdo lloj komitetesh, shoqatash, organizatash a partish politike të mërgatës shqiptare ten-tojshin me e bâ Camajn për vete, me e angazhue për qëllimet e tyne politike. Mirëpo, ky i mbette besnik parimit të vet mos me u përzie në punërash politike të komiteteve, shoqatave dhe organizatave në

mërgim. Përndryshe, në politikë ai nuk i kishte simpati konservatorët, por liberalët.

BISEDAT E PLEQNUEME

Ndër biseda, Camaj fliste me zâ të ultë dhe fjalët i matte mirë. Kur i bëje nji pyetje, shpesh heshte gjatë për t'u mendue mirë dhe mbasandej të befasoi me nji përgjigje fare të papritun, kujton Lankschi. Mbas "pleqnimit më vete", mbas dyshimesh e të kenët ndërlyzash, Camaj gjithmonë mbërrinte te kjtartësia. "Përgjigjet, prononcimet a gjykimet e tij ishin aq kuvendvogla e të thjeshta në dukje sa dhe të kjarta e të kthjellta, si të kullueme në 'kthjellësinë e idhtë/ edhë nëse pa gjuhë. Kurrë nuk të jepte ndonji përgjigje me fjalë boshe a fraza stereotipe siç e kanë zakon me i çaprashtitë letrarët që mendojnë se janë njerëz të posaçëm ku çdo fjalë e tyne duhet me kenë diç e jashtëzakonshme", shkruan Lanksch.

Shton, se pesha e fjalës së Martin Camajt qëndronte — si dhe në vargjet e tij — në thellësinë e saj të kombinueme me trajtën e jashtme të gdhendun deri në thjeshtësi të skajshme. Punët që i kishte sidomos për zemër, i thoshte në mënyrë sidomos joimponuese dhe modeste, shpesh me dy-tri fjalë a me nji gjysmëfjali. "Mos me u përlye", tha për shembull në vend të nji logoreje të gjatë. Edhe pse të befasonte me përgjigje e qëndrime të paprituna e jo konvencionale, fjala e tij kurrë nuk ishte zhangluese. Etiketimet dhe insinuata në nivel personal që bâhen shpesh mes letrarëve shqiptarë, Camajt i ishin absolutisht të hueja. Ai fliste shkoqun, me argumente e parime.

NJI MBRAMJE LETRARE

Nji kapitull me vete qe e vetmja mbramje letrare e Martin Camajt në Gjermani. Botimi i parë i poezive të Camajt në gjermanisht asht bâ më 1990 te revista letrare

"Sirene". Hans Joachim Lanksch kujton se redaktorët e revistës kuptuen se po botojshin nji poet të madh dhe organizuen nji takim të autorit me publikun gjerman. Martin Camaj kundërshtojte fort. "Nuk di me recitue", ngulte kambë, "unë lexoj dobët". Mbas nji lufte të gjatë e të randë, mâ në fund ai pranoi me u shfaq para publikut dhe me lexue nji cikël poezish shqip (versionet gjermanisht i lexoi nji aktore teatri) dhe — ai lexoi për mrekulli. Për fat të mirë në të vërtetë nuk dinte me "recitue". Leximi i tij bani përshtypje të thellë mbi të pranishmit. Camaj i lexoi poezitë fort natyrshëm dhe me thjeshtësi të përsosun të kombinueme me ekspresivitet të jashtëzakonshëm. Thjeshtësia e leximit të Camajt, larg çdo bombastike recitimi poezi-vrasës ishte simptomatike: si vetja e tij ashtu, edhe vepra e tij ndërthuren prej kompleksitetit dhe thellësisë që manifestoheshin me thjeshtësinë e madhe të shprehjes dhe dukjes së tyne të jashtme.

Ish-studenti, thotë se Martin Camaj zemrën nuk e kishte akull. Nuk ishte në kontakt me familjen e vet në Temal, familjen në Shqipni, e kishte mall, por nuk mbante lidhje me të mbasi nuk dëshironte me e vû në rrezik. "Mâ mirë mos me dijtë gjâ për ta", tha me nji farë humori të idhtë. Mirëpo, zemra e tij rrihte gjithnji për "njerëzit e mij". Zemra e profesorit universitar rrihte për njerëzit e thjeshtë. Profesori shkante me punëtorë krahu, shqiptarë prej Kosovet, nëpër zyra gjermane tue i ndihmue ata me gjetë banesë e punë. Nuk janë të paktë ata që i ndihmonte edhe me para. Mbramjeve ishte koha për të folë në telefon me Martin Camajn, mbas orës 19.30, mbas përfundimit të Ditarit në kanal in e dytë televiziv gjerman. Në këtë kohë ai fliste me familjen e vet të gjanë dmth., me shqiptarët mërgimtarë anëmbanë botës, me profesora a studentë dhe punëtorë a gazetarë, prej Gjermaniet e Italië deri në Amerikë.

Martin Camaj nuk ishte shkrimtar i tipit "mërgimtar". Nuk shkruente vjersha sentimentale për vendlindjen, nuk e përshkruente me lot në pendë pejsazhin e vendlindjes. Nuk shkruente as pamflete me ideologji antikomuniste. Nuk ishte poet politik. Në veprën e tij hasim vetëm nji gjysmë duzinë poezish me përmbajtje shprehimisht politike, të cilat ndërkaq nuk përzihen me politikën e ditës, por i trajtojnë temat e dhunës. "Nuk jam njeri i politikës. Jam njeri politik", ka kenë deviza e tij.

(Gazeta Shqiptare)

Kanë thënë për poetin

“Xhevahir Spahiu është një nga poetët më të mirë që ka Shqipëria, poet me një shprehje të fuqishme metaforike, me përplasje idesh, me një frymë lirike dhe zhvillim dramatik të vargut, me një figuracion të plotë, por kryesisht me ide të thella, tronditëse.”
Dritëro Agolli

“Energjiku Xhevahir Spahiu nuk është poet-murg dhomash të mbyllura apo i një vetmie të humbur në mendime. Poezia e Xhevahir Spahiut, e këtij “enfant terrible” të letërsisë shqiptare është e fuqishme dhe solide, por njëkohësisht është poezi e ngjyrimëve dhe shkallëzimeve kuptimore.”
Robert Elsie (Historia e letërsisë shqiptare, Nju Jork 1995)

“Talenti i tij poetik luksoz e identiteti krijues i pakrahasueshëm, bashkojnë rreth vetes tematikën me një përsosmëri të vazhdueshme të gjykimit të tij...”


Ante Popovski, Shkup, 1998

“Poezia e Xhevahir Spahiut është poezi kryeneçe në ndeshje me vetveten dhe me jetën. Poezitë e tij janë skulptura”.
Ndoc Papeleka

“Prej formave të pafundme të dashurisë, poezia e Xhevahir Spahiut shndërrohet në joshje, që nxit dhe grish. Poeti, njëlloj si në fillësën e marrëdhënies, gjen vendin në botë. Poezia rifiton vlerën e harruar. Ajo mund të ndihmojë sërish. Dikush kapërcen vetminë. Dikush gjen fjalën e duhur mes fjalëve të humbura. Një tjetër mban mend vargje të kthjellët, të fuqishëm, plot tingull dhe kuptim, ashtu siç i ndeshim në poezinë e Xhevahir Spahiut. Falë origjinalitetit, kjo poezi na shtyn të besojmë se ç'ishite e poetit është bërë tashmë dritë brenda atij që lexon apo mban vesh ato fjalë.”

Arian LEKA

“Poezia e Xhevahir Spahiut, e këtij “enfant terrible” të letërsisë shqiptare është e fuqishme dhe solide, por njëkohësisht është poezi e ngjyrimëve dhe shkallëzimeve kuptimore.”—Robert Elsie



XHEVAHIR SPAHIU

FJALA

*I thanë fjalës: tani je e lirë.
Po fjala s'kish fuqi t'u thosh: nuk më duhet.
E ç'më duhet kur s'u thashë atëherë kur duhet?!
Kam mbetur pa krahë,
kam mbetur pa qiell,
jam jetë pa ëndërr,
jam ëndërr pa jetë.
I thanë fjalës: je e lirë;
pasi ke ngrënë rrokjet e tua,
pasi ke mbetur cung dhe liria bëhet burg.
I thanë fjalës: liria jeton.
Fjala ua ktheu:
s'jam Konstandini që pa vdekjes udhëton.
I thanë fjalës: ti je liria;
për ta kuptuar këtë të duhet fare pak.
Ajo e besoi,
ajo hapi gojën,
po në vend të tingujve prej saj doli gjak.*

MESNATË DIMËRORE

*Asnjë zë. Të lodhur prej ditës marrin një sy gjumë stacionet.
Bota të mos mbetet pa muzikë,
bubullijnë horizontet.*

NJERIU PA EMËR

*Jam njeri pa emër,
jetoj në balada.
Ç'është ai që kalon?—pyesin njerëzit në rrugë.
Si e quajnë? Si?
O shok!
O burrë i dheut!
O njeri!
Unë eci dhe kokën s'e kthej,
jam njeri pa emër dhe në ç'kohë jetojmë nuk e di:
emrin ma kanë kyçur në dosje dhe zyra,
ia shtrëngojnë qafën me rrathe kuqalashë,
ia shtojnë pikëpyetjet si kosa kërcënuese,
tmerrohen kur unë dhe emri im jemi bashkë.
Jam njeri pa emër,
jam emërharruar.
Mos njerëzit kanë harruar të flasin, të shkruajnë?
O zot, më keq akoma:
kanë harruar të duan.
Ku shkoi emri im,
ma tregoni pak varrin.
Kam frikë se ndonjë ditë do të dal si*

*i çmendur,
të kap cilindo për mënge në rrugë e ta pyes:
Më thuaj, o njeri:
Si quhem unë?
25 gusht 1985*

FEMIJËT E MALIT TË SHENJTË

*Atje tek ujët e zi,
oi, nëna ime, oi,
fëmijët e Malit të Shenjtë as libra, as bukë nuk kanë,
as flasin, as qeshin, as qajnë,
uria vetë ka uri,
oi, nëna ime, oi.
burimet si shpirtira të kthjellët gëlltitin një vaj të humnertë;
o bija përrallash, o bij,
jam larg e nuk mundem të vij.
tri re me rrufë zënë e lozin prej reve, pa shih!—mitralozi!
dhe zi e më zi e më zi,
oi, nëna ime, oi.
përkulet kaprollja mbi foshnja t'u lidhë plagët e plumbit,
po pikë rakie nuk ka as në katundin e fundit.
nata pagane shkul flokët,
lisat gremisen përtokë,
nxin ujët e ujit të zi,—
jam larg e nuk mundem të vij.
oi, nëna ime, oi.*

ULJE ÇMIMESH

*30 lekë një kg. mish,
një bukë e zezë 4 lekë.
Po më lirë?
Një kg dinjitet.*

MIÇO

*Unë s'jam i vdekur që të mos gaboj.
Hiqi syzet, Miçooo!
Diçka ti përtyt:
“Ç'të raportoj?”
O ju sy, sy të Miços që dhelpërisht shkëlqeni,
kur unë gaboj.
Gjoja rastësisht u the shefave,
në kafe kur pagove:
“Vjershat i kërrën në orarin zyrtar,
dhe... si shumë u kundërshton eprorëve...”
Kur e di që ka Miço unë e gdhij gjer në tre pas mesnate;
po ti pse u zverdhe,
ç'pate?
Thyeji syzet, Miçooo,
kuptoje bujarinë time të pafund.
E ç'do të ishe ti, o mor i gjorë,
po të mos gaboja unë?*

NESËR JAM ATY

*Nesër jam aty,
U bëni zë lisave të më dalin përpara
në këmbë të babait.
Medet sa jam rritur,
lisat sa të vegjël!
Babai u hidhte supeve pjergullën:
i besoja babait, bokërimat e dinë:
ish ai perëndia që kish shpikur hardhinë.
Me të kish punë vetëm puna.
Ç'la pa krasitur?
Le ta thotë Juga.
Nesër jam aty.
Currës me kupën e gurtë i thoni ta ruajë, po munda, një grusht ujë për mua.
Kam një etje të moçme.
Vij i lodhur nga rruga.
Nesër jam aty.
Këpucët do t'i heq në të hyrë të fshatit;
ngashërimi do t'ia shkundë fletën e fundit manit,
(Fletë e fundit a fjalë e pathënë e babait?)
Thinjjen time fëmijëria do ta shtyjë në kufijtë e harresës.
Jam aty,
nesër.*

NGJARJE NË TREN

*Gjeli me lafshë të kuqe,
me kikiriku-n e zgjimit në fyt.
Gjel pa qiell. Qiell pa gjel.
Gjysmagjel.
Çerekgjel.
Lafsha krenare, flamur gjysmështizë,
përpëlitet brenda çantës në terr.
Hape atë çantë.
ta marrë djalli, ta marrë,
siç ke hapur për vete dritaret e trenit,
atje brenda po fiket kënga e gjelit.
Ora e gjelit, orë zgjimi, ka mbetur.
Treni po ecën me gjelin e vdekur.
A thua të zbresim një nga një si në zi me gjelin përmbysur përmbi glasat e tij?
Endë pa u dergjur në bark a nën tokë,
mua më këndojnë 40 gjela në kokë.
1989*

PËRKTHIMI I LUMIT


*Rri dhe përkthej lumin.
Përkthim i vështirë ky i ujërave.
Fjalë të rralla,
shprehje të ngurosura,
ritëm i tejkohëve.
Njëqind burime njëzëri mitin e moçëm kallzonin.
Gjithë natën përktheva lumin.
Në mëngjes përkthimi ishte zhdukur.
Skrapar, 1983
KU
Nata korb i zi.
Ku të shkosh?
As lart.
As poshtë.
Syri në syrin e pleshtit,
kokrra në kokrrën e elbit,
dreqi në thelbin e dreqit.
Xhepat bosh.
Bosh?
Boshi i boshtit pa bosht.
Nata korb i zi.
Ku të shkosh?

*A ka gjëkund ndonjë shitore a ndonjë tezgë kot më kot,—
të ble me ca qindarka qorre,
jo bukë, po pak durim, o Zot?

*Malo Sevrani
Një gjysmë molle kuqëlon në degë.
Zogu, që gjysmën tjetër kishte ngrënë,
për mua udhëtarin e kish lënë.*

LIGJËRIM MBI QENIN PA JETË

*Qeni im, kush të vrau,
e pse të vrau, qeni im?
Shtrirë si dhembje përmbi bar pranë lules së gjakut tënd;
sytë e tu të hapur dikë presin t'i mbyllë,
dy lehje të pakuptuara sytë e tu.
Po vijnë delet gjakun tënd të lëpijnë,
tunde pakëz bishtin si biskonjë prilli.
S'ka paksa që hënës mitikisht i lehje,
dhe tani... dru i prerë... heshtje...
Një histori dhelpash është varrosur me ty;
atje në bjeshkë,
atje në vërrin ujku nga tronditja bren këmbën e tij.
Ti i pagjumi kur edhe krojet flinin,
ti bir i besës kur pabesitë nxinin,
ma ktheve kërrabën në hakërrim drejt qiejve;
e ndien si rrëzohen mbi sytë e tu të zbrazët lotët e nxehtë të mi?
Angulli dhe njëherë,
të mos angullij.*



Libri "Shalli i zi" i Luigji Pirandellos titullin e merr nga një prej tregimeve më të dhimbshme. Është jeta dhe sakrificat e një

“Shalli i zi” i Pirandellos

motre për të vëllanë dhe më pas “braktisja” dhe “internimi” i saj në një martesë mbyttëse, që e çon drejt fundit.

Është zhbërja e njeriut nga vështirësitë e jetës kur pavarësisht se çka dhënë, nuk merr mbarsht as mirënjohje e as besim – në këmbim të të gjithave, ajo humb nderin sipas konceptit të kohës kur u shkrua, por humb edhe ata që i deshi. Leximet mund të jenë disa, këndvështrimet po ashtu. Ajo është historia e një gruaje, por është edhe historia e një njeriu çfarëdo, që gaboi vetëm një herë e nuk ia falën, anipse deri atë ditë nuk kish gabuar kurrë e kish dhënë shumë.

Eleonora Bandi e sheh jetën e saj të shkërmoqet përditë nga pak, deri kur dhimbja bëhet më e fortë se logjika, për ta tretur larg.

E vetmuar, ajo grua që e kish shkuar jetën në ‘ndershmëri’, në të vetmin rast që ‘gaboi’ i humbi të gjitha.

Historia e Eleonora Bandit dhe të vëllait Giorgios, historia e Bandit me Gerlandon

bëhen pikënisja e një fati tragjik, ku nuk ka vend për ata që gabojnë. Teksa shalli i zi është gjithë ç’mbetet prej Eleonorës, autori sjell në vëmendje ende sot ‘shajet e zeza’ përreth nesh, ku fati tragjik ende përndjek gra e vajza, për ‘nderin dhe lavdinë’ e burrave, vëllezërve e baballarëve.

Ky tregim është njëri prej disave dhe ka shërbyer si titull për vëllimin e Luigi Pirandellos, botuar nga “Çabej” nën titullin, “Shalli i zi e tregime të tjera”.

Këto tregime, pjesë e përmbledhjes “Novela për një vit”, u shkruan ndërmjet viteve 1894-1920.

Ato janë një radiografi e pamëshirshme e marrëdhënieve njerëzore, arsye për të cilën mbeten kaq aktuale edhe sot. Të ardhura në shqip me përkthimin mjeshëtor të Mustafa Greblleshit, tregimet e Luigi Pirandellos do të mund t’i gjeni në harkun e pak ditëve në çdo librari. Botohen për herë të parë, edhe pse u përkthyen gjatë shekullit të kaluar./ F. NIKOLLI



Romanet e Ismail Kadaresë 1963 - 1990

Objekt i studimit të këtij punimi monografik janë romanet e Ismail Kadaresë të botuara nga viti 1963 e deri në vitin 1990. Romanet analizohen në dy rrafshë, retorika e tekstit dhe narracioni. Këto rrafshë janë të ndërlidhura fuqishëm te krijimtaria narrative e Kadaresë. Kjo ndërlidhje arrihet përmes autorit të nënkuptuar, instancë fiksonale, por njëkohësisht, në këtë rast, 'përfaqësues' i autorit real brenda tekstit.

“Në këtë studim, shkrimtari Gëzim Aliu, ka analizuar gjithsej pesëmbëdhjetë romane të cilët janë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Përbindëshi”, “Dasma”, “Kështjella”, “Kronikë në gur”, “Dimri i vetmisë së madhe”, “Nëntori i një kryeqyteti”, “Ura me tri harqe”, “Pashallëqet e mëdha”, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Prilli i thyer”, “Kush e solli Doruntinën”, “Koncert në fund të dimrit”, “Dosja H” dhe “Viti i mbrapshtë”.

Kjo monografi ashtu siç na tregon edhe vetë titulli objekt studimi ka romanet e shkrimtarit madh Ismail Kadare të periudhës kohore 1963-1990. Në një rrëfim shkrimtari Aliu, tregoi në detaje në lidhje me këtë monografi e cila i ka marrë kohë dikur rreth pesë vite punë. “Romanet i kam analizuar në dy rrafshë të ndërlidhura: retorika e tekstit dhe narracioni, që përbëjnë edhe dy pjesët e punimit. Retorikën e tekstit të romaneve të Kadaresë e kam parë në ballafaqim me retorikën e doktrinës së realizmit socialist që, në periudhën në fjalë, synonte ta shndërronte letërsinë në mjet propagande”, tha fillimisht Aliu, i cili tregoi tutje se në pjesën e dytë i ka analizuar anët formale e teknike të narracionit.”

PRINCIPATA SHQIPËRI - Karl Thopia

Autori Karl Thopia, nisur nga emri por edhe nga disa prej kulturave në analizën që i bën shqiptarëve të kohës, me gjasa të mira ka qenë shqiptar në origjinë, i mirintegruar në strukturat austro-hungareze. Përqasja e tij (mendoj) e dyfishtë kulturore-politike, i ka mundësuar studimin e kujdesshëm të ngjarjeve, filtrimin, përpunimin e informacionit dhe dhënien e përfundimeve nga këndvështrimi i perandorisë. Shumë fakte mund të lexohen ndoshta për herë të parë në shqip përmes këtij botimi, si për makinaçionet e Esad Pashë Toptanit, i cili mbështetur nga qeveria italiane, por edhe e vendeve të tjera fqinjë, shërbeu si strumbullar e katalizator i trazirave që çuan në rënien e principatës; ashtu edhe për teatrin grek të realizuar deri në detaje me gjithë krimet shfarosëse që e përbënë atë në thelb, për pushtimin e Jugut të Shqipërisë; apo për përfshirjen e mediave franceze në amplifikimin e teatrit grek dhe mbulimin e asaj që po ndodhte realisht si krim kundër një populli; apo për angazhimin e spikatur të misionit hollandez për mbrojtjen e interesave të principatës; apo edhe për disa qëndrime të Ismail



Qemalit sipas autorit, për të cilat si përkthyes, në lexim e në përgatitjen e botimit i kam shoqëruar me mospranim, duke pasur sidomos parasysh që Ismail Qemali ishte personaliteti i mbështetur në mënyrë të posaçme edhe nga vetë Perandoria Austro-Hungareze, për të mundësuar shpalljen e pavarësisë dhe

ndërtimin e qeverisë së parë shqiptare. Kjo periudhë historike mbetet ende e paqartë në formë të plotë për ne si pasardhës të këtij vendi dhe kjo paraqitje kthjelluese mund të ndihmojë më tepër për njohjen më të mirë të aftësive e vështirësive tona në procesin e shtetformimit.


Një ditë në natën pa fund (Dafina të thara)

Në këtë libër vijnë kujtime dhe reflektive përmasash deri dhe filozofike të Kasem Trebeshinës, disidenti shqiptar, të cilat sjellin kohën dhe hapësirën e pafundme kuministe dhe besimin se do të vijë së shpejti dita e lirisë. Ky libër vlerësohet si një dëshmi e shkruar që ka lënë autori para se të ndahej nga jeta.

“Kjo është historia e jetës sime. Vazhdimin e saj do ta gjeni në shkrimet e mia, se, që nga viti 1955, e lashë pikturën mënjane dhe u mora tërësisht me letërsi... Tashti, si çdo njeri tjetër në Shqipëri, edhe unë jam i dënuar me burgim të përjetshëm. Që me rrezën e parë të agimit dhe gjer në muzg të gjithë jemi të detyruar të shohim vetëm bunkerët e kotë, piramidat dhe sfinkset e Enver Hoxhës...

Dhe askush nuk mund ta parashikojë dot fundin e kësaj mbretërie të terrorizmit absolut, sepse Shqipëria është një vend i humbur, sepse shqiptarët janë një popull i humbur, pa një shtresë të vërtetë udhëheqëse, të dënuar të enden përjetësisht në një rreth të mbyllur...Tashti, para lamtumirës, dua t’ju kujtoj se e gjithë kjo që na duket se e shikojmë është sa e madhërishme, aq edhe e tmerrshme!...Ju mos e bëni më të padurueshme, gjer në shkatërrim!...Dhe mos harroni!... Diktaturat nuk i kemi lënë pas!... Diktaturat më të tmerrshme, të ngarkuara edhe me shkencë, do t’i keni përpara!...Mendohuni mirë... Për të mirën tuaj dhe të atyre që do të vijnë!...

Lamtumirë!...”, shkruan Kasëm Trebeshina



Drafti i Strategjisë së Mbrojtjes, i publikuar nga Ministria e Mbrojtjes serbe thotë se Serbia do të vazhdojë bashkëpunimin e saj me NATO-n dhe Organizatat e Traktatit të Sigurisë Kolektive si një vend ushtarak neutral.

Siç vuri në dukje 'Blic' teksti i këtij drafti do të bëhet publik në tryeza të rrumbullakëta të cilat do të mbahen në Novi Sad, Nish dhe Beograd.

Një pjesë e draftit i cili është publikuar në gazetë, thekson se Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës por do të punojë në interes të stabilitetit rajonal dhe marrëdhënieve të mira të mundshme serbo-shqiptare për të vazhduar dialogun me institucionet e 'përkohshme të Prishtinës' me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, përcjellë lajmi.net.

"Është pohuar se Serbia do të angazhohet për një zbatim të përpiktë dhe të qëndrueshëm të të gjitha marrëveshjeve të arritura në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit dhe të jetë aktive në organizatat ndërkombëtare, do të ketë bashkëpunim bilateral që të përpiket të parandalojë njohjen e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare në veçanti

SERBIA E VENDOSUR TË PENGOJË KOSOVËN



në OKB". Tutje, gazeta thekson se Serbia do të japë mbështetje të plotë për pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Prishtinës në mënyrë që të mbrojnë popullatën serbe, të rrisë sigurinë e të gjithë

qytetarëve dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me rezolutën 1244.

Po ashtu, thuhet se Serbia është e angazhuar për praninë e vazhdueshme të KFOR-it dhe se

kundërshton ndryshimin e mandatit dhe transformimit të forcave të armatosura në ushtri pasi sipas tyre kjo do të destabilizonte situatën në Kosovë dhe do ta dëmtojte sigurinë në rajon.



Spanja përdor veton ndaj Kosovës

Diplomacia spanjolle ka vënë veton ndaj një deklarate të përbashkët që Bashkimi Evropian synon të nënshkruajë me vendet e atij rajoni në samitin që do të mbahet në më pak se një muaj në Bullgari.

Arsyet pothuajse nuk kanë të bëjnë me politikën e jashtme të BE-së. Qëllimi është që të mos përfshihet emri i kryeministrit spanjoll Mariano Rajoy në të njëjtin dokument me atë të udhëheqësit të Kosovës, të cilën Spanja nuk e njeh si shtet.

Pas bllokadës spanjolle, Evropa do të marrë pjesë në një takim me një deklaratë ekskluzive nga udhëheqësit evropianë, duke mos përfshirë Ballkanin, raporton "El Pais", përcjell zeri.info. Takimi i Ballkanit, i pari i mbajtur me atë rajon kyç për Evropën për 15 vjet, po dëshmohej me problematik se sa që pritej.

Megjithëse katër shtetet e tjera që e mohojnë statusin Kosovën si shtet nuk janë të kënaqur me formatin, Spanja është e vetmja që propozon seriozisht të mos marrë pjesë në takim dhe që më në fund ka bllokuar deklaratën e përbashkët, siç është konfirmuar nga burimet diplomatike.

Serbia furnizohet me 4 avionë luftarakë

Shteti i Bjellorusisë ia ka dhuruar Serbisë katër avionë luftarak "Mig-29", të cilët pas një remonti do të modernizohen sipas modelit të njëjtë të 6 avionëve tjerë luftarakë që i janë dhuruar nga Rusia, ka deklaruar ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandër Vulin. Vulin ka shtuar se dhurimi i këtyre avionëve është pas një marrëveshje mes presidentit serb, Aleksandër Vuçiq dhe atij bjellorus, Alekdandër Llukashenko. Ministri serb i Mbrojtjes ka bërë të ditur se për një vit Serbia do të ketë avionë të modernizuar "mig-29", si dhe



do të arrijnë helikopterët e parë "H-145M". Ministri serb i Mbrojtjes ka potencuar se ekzistojnë tenti-

me për shkeljen e hapësirës ajrore të Serbisë, të cilat siç ka thënë ai janë zbuluar dhe parandaluar.

Inskenohet dasma e Skënderbeut, pas 567 vjetësh

Në fshatin Kaninë të Vlorës është riinskenuar dasma e Skënderbeut. Dhjetëra vetë të veshur si dasmorë, por edhe si Donika e Gjergj Kastrioti u mblodhën në Kalanë e Kaninës.

Pikërisht në këtë kala, 567 vjet më parë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu lidhi kurorë me një vajzë vendase, Donika Arianitin, një martesë që u konsiderua si dasma e

bashkimit veri-jug.

Mes dasmorëve ishin shqiptarë nga e gjithë bota, por edhe 60 arbëreshë të Italisë, ndër të cilët pasardhës të Skënderbeut.

"Faleminderit të gjithëve! Unë jam shqiptar. Nëse nuk do të ndodhte kjo martesë, unë nuk do isha këtu. Kemi mundësinë që të bashkohemi sot me gjakun shqiptar. Kemi qenë larg për shumë

kohë. Na ka ndarë historia, por ka ardhur momenti që të bashkohe mi. Evropa duhet ta respektojë rëndësinë e Shqipërisë dhe ne shqiptarët e shpërndarë nëpër botë duhet ta bëjmë të mundur këtë", u shpreh Loris Castriota Scanderbeg, transmeton tch.

Festa në vitin e Skënderbeut vazhdon në Manastirin e Ardenicës dhe në Tiranë.



Schlauch: Aseti i Shqipërisë është uji

Politikani gjerman, Rezzo Schlauch, një ekspert në çështjet ekonomike, ka dënuar përpjekjet e dobëta të qeverisë shqiptare dhe të pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor për të përthithur investime të huaja direkte.

Gjatë fjalës së tij në "SCAN Economic Forum", Schlauch ka dhënë edhe vërejtjet e tij për problemet që kanë ngadalësuar progresin e vendeve të Ballkanit drejt integritimit Evropian.

"Mendoj se procesi politik duhet të mbështetet nga një proces ekonomik dhe në këtë fushë unë mendoj se këtu ka shumë hapësirë të mbetur. Kur shikoj ritmet e investimeve të huaja direkte, Shqipëria është në një nivel të qëndrueshëm prej vitesh por të ulët. Dhe mendoj se kjo është e pamjaftueshme.

Nëse një vend i fuqishëm industrial si Gjermania, zë vetëm 1% të investimeve të huaja direkte në Shqipëri, në një rën anë ky është problem i Gjermanisë, por jo vetëm.

Mendoj se angazhimi i institucioneve shqiptare duhet të punojë në mënyrë më proaktive për të nxitur investimet e huaja direkte, jo vetëm prej Gjermanisë, por edhe prej vendeve të tjera perëndimore. Është edhe më problematike nëse i shohim këto investime, Ato përqendrohen në tre ose katër projekte, si TAP, si Statkraft, si Bankers Petroleum.

Dhe nëse shohim panoramën e madhe, në pikëpamjen time është shumë më pak dhe do të thosha se në këto fusha kam përvojat e mia sepse kam punuar për qeverinë turke për thithjen e investimeve të huaja direkte nga Gjermania drejt Turqisë dhe përpjekjet e tyre përqendrohen në përthithjen e investimeve të huaja direkte prej mbarë botës. Nuk mund të krahasohen me Shqipërinë, sepse Shqipëria nuk i ka ende ato lloj burimesh për të qenë aktive në këtë fushë, por mendoj se një angazhim më proaktiv do të ishte me vlerë", tha Schlauch./Scan-tv

IRANIANËT NË KRIZË, BLERJA E DOLLARIT ARRIN KULMIN

Çdo ditë, qindra iraniane ia mësyjnë rrugës Ferdowsi në Teheran për të blerë valuta të huaja. Por, tani qytetarët po i gjejnë shumicën e këmbimoreve të mbyllura dhe në hyrje të tyre po shkruan njoftimi "Nuk kemi dollarë amerikanë për të shitur"



NUK ISHIM TË PËRGATITUR PËR KËTË

Masat e reja po prekin iraniane, të cilët studiojnë, udhëtojnë apo bëjnë biznes jashtë vendit, si dhe ata që kursimet e tyre i kanë në dollarë. "Familja ime e ka dërguar vëllain për të studiuar jashtë. Ditën kur ai shkoi, kursi i këmbimit u bë 35 mijë rialë për një dollar. Tani, fatqesisht, dollari këmbëhet me 60 mijë rialë", thotë një iraniane, i cili nuk ka dashur të identifikohet. "Tani, ne nuk mund t'i dërgojmë më para vëllait", thotë ai, duke shtuar se "ne nuk ishim të përgatitur për këtë".

Presidenti Hasan Rohani, që fitoi mandatin e dytë më 2017, kishte premtuar se do të hapte vende të reja të punës, në ekonominë e goditur nga recensionet. "Një nga arsytet që kam votuar për Rohanin ishte se mendoja se ai mund ta përmirësonte ekonominë. Por, në muajt e fundit kemi parë, për fat të keq, se administrata nuk ka politikë apo aftësitë e duhura për të përmirësuar ekonominë", thotë ky i ri iraniane. Valuta e Iranit ka humbur përafërsisht gjysmën e vlerës së saj në tregun e lirë që prej shtatorit të vitit të kaluar. Këmbimi me dollar amerikan arritur shifrën

rekorde javën e kaluar, ku një dollar këmbëhet për 60 mijë rialë. Steve Hanke, profesor i ekonomisë në Universitetin Johns Hopkins në Batorim, thotë se keqmenaxhimi ekonomik dhe sanksionet ndërkombëtare ndaj Iranit, kanë krijuar "stuhinë e përsosur të valutës". Irani nuk ka qenë në gjendje të përfitojë nga marrëveshja bërthamore e arritur më 2015 me fuqitë botërore, përmes së cilës Teherani i lehtësohen sanksionet në këmbim të frenimit të programit bërthamor. Kjo është pjesërisht për shkak të rezistencës së kampit konservator të Iranit që të hapin ekonominë e kontrolluar nga shteti, por edhe nga sanksionet që SHBA ka vendosur për shkak të shkeljeve të drejtave të njeriut dhe programit të raketave balistike. Po ashtu, kompanitë evropiane kanë qenë të kujdesshme për të investuar në Iran, për shkak të frikës nga dënimet e SHBA-së. Ekonomistët vlerësojnë se të gjitha këto kanë ndikuar në qasjen e Iranit ndaj marrëdhënieve tregtare, financave dhe investimeve të huaja. "Sistemi i ri për këmbimin e valutave është i destinuar të dështojë", thotë Hanke, duke shtuar se "iraniane do të përdorin tregun e zi për të si-

gurar valuta të huaja. Gjithashtu, asnjë ekonomi nuk ka lulëzuar nga zhvlerësimet".

LUFTA EKONOMIKE

Qeveria e Rohanit për këtë krizë ua ka hedhur fajin kritikëve në vend dhe jashtë. Zëdhënësi i Qeverisë, Mohammad Baqer Nobakhta ka thënë se Irani është "në një luftë ekonomike me armiqtë që kërkojnë të krijojnë probleme për ekonominë tonë". Guvernatori i Bankës Qendrore iraniane, Valiollah Seif, është përballur me ligjvënësitë në Parlament javën e kaluar, të cilët kërkuar dorëheqjen e tij. Seif u arsyetua se zhvlerësimi i valutës iraniane ka ndodhur për shkak të "mungesës së sigurisë" për të ardhmen, dhe tha se "armiqtë e njohin problemin dhe po përpiqen të përdorin çdo mundësi" për t'i shkaktuar telashe Iranit. Ai gjithashtu sugjeroi se për këtë krizë ka "gjurmë të komplotit" nga rivalët rajonalë, duke përfshirë Arabinë Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, por nuk dha më shumë detaje për këtë gjë. Ndërkaq, nënpresidenti Eshagh Jahangiri ka fajësuar "faktorët joekonomikë, të pajustificuar dhe të paparashikueshëm" për kolapsimin e rialit.



Lufta e Ftohtë është kthyer në skenë

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (OKB), Antonio Guterres, tha se beson që bota po kalon përmes një Luftë të re të ftohtë. "Mendoj se bota vëren qartë se Lufta e Ftohtë u kthye në skenë. Megjithatë, ka një dallim në mes kësaj për të cilën jemi dëshmitarë dhe Luftës së Ftohtë nga e kaluara", tha Guterres, në një intervistë për televizionin suedez SVT. Duke theksuar se SHBA dhe Rusia sot nuk kontrollojnë mbarë botën, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së tha se sot ka edhe aktor të tjerë mjaft aktiv si Turqia, Irani dhe Arabia Saudite. "Është e qartë se sot nuk ka dy blloqe homogjene dhe mirë të kontrolluara", tha Guterres, duke shtuar se dallimi tjetër është se sot nuk ka mekanizëm të dialogut të cilat në kohën e Luftës së fundit të Ftohtë kanë shërbyer si mekanizëm kontrolli për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit. Guterres shprehu gjithashtu kënaqësi për faktin se situata u qetësua pas ngjarjeve të javës së kaluar në Siri. "Shpresoj se do të gjendet konsensus ashtu që tensionet e javës së fundit të mos përsëriten", përfundoi Guterres. SHBA, Britania e Madhe dhe Franca javën e kaluar kryen sulme me raketa në Siri pa miratimin e Këshillit të Sigurimit. Këto vende kryen sulme në përgjigje të përdorimit të armëve kimike në Duma, ndërsa Rusia sulmet i quajti si agresion kundër sovranitetit sirian.

DEKLARATË ÇNJERËZORE E DEPUTETIT IZRAELIT

Tamimi duhej qëlluar në gju

Pjesëtari i Partisë Shtëpia Hebreje në Izrael, Bezalel Smotrich, ka deklaruar se adoleshentja palestineze Ahed Tamimi, e cila është bërë njëra prej simboleve të Palestnës me guxim të saj duke kundërshtuar okupimin, "do të duhej të qëllonte në gjurin e saj". "Sipas meje, ajo vajzë (Ahed Tamimi), të paktën do të duhej të qëllonte në gjurin e saj dhe në këtë mënyrë do të dënohej me burgim të përjetshëm shtëpiak", ka shkruar Smotrich në llo-

garinë e tij në rrjetin social Twitter. Ndërkaq, deputetja nga partia Maretz, Michal Rozin, e ka kritikuar deklaratën në fjalë. "Duhet të turpërohesh nga vetja. Javën e kaluar, kolonët hebrej hodhën gurë në drejtim të ushtrisë izraelite. A guajtën me armë zjarri kundër tyre?", ka thënë Rozin. Ahed Tamimi, 17 vjeçare, është dënuar me tetë muaj burgim pasi ishte arrestuar nga ushtria izraelite më 19 dhjetor të vitit 2017 gjatë një bastisjeje në shtëpinë e saj. Arre-

stim i saj kishte ndodhur pasi mediat izraelite kishin publikuar pamje teksa Ahed i godiste me shuplakë një ushtar izraelit i cili kishte hyrë me forcë në oborrin e shtëpisë së saj në Nebi Salih, në afërsi të qytetit Ramallah në Bregun Perëndimor të okupuar. Ajo akuzohej për "sulm" ndaj ushtarëve izraelite. Ahed, e cila njihet si "guximtarja palestineze", në vitin 2012 në Stamboll ishte shpërblyer me çmimin për kurajo Handhala, për qëndrimin e saj të guximshëm



ndaj ushtarëve izraelitë teksa këta po arrestonin vëllain e saj. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdoğan, në atë kohë kryeministër, u takua personalisht me vajzën palestine-

ze për të shprehur admirimin e tij për trimërinë e saj. Tamimi po mbahet në burgun ushtarak të Izraelit, i cili ndodhet në Bregun Perëndimor të pushtuar.

Zemra si organ muskolor luan rolin e pompës e cila e shtyn gjakun në qarkullim. Zemra, arteriet, venat dhe kapilarët formojnë sistem të mbyllur të gjakut. Është organ i zgavruar muskolor i përbërë prej dy zgavrave më të vogla, veshëza, dhe në dy zgavra më të mëdha, barkushe, të cilët tkurren dhe shtrihen duke e detyruar gjakun të qarkullojë. Arteriet janë enë elastike të gjakut, të cilat gjakun e largojnë nga zemra. Venat janë enë të buta elastike të cilat e sjellin gjakun në zemër. Puna e muskujve dhe organeve të tjera e shtyn gjakun nëpër to. Kapilarët e gjakut janë enët më të holla të gjakut përmes të cilave bëhet këmbimi i materieve ushqyese në gjak, transmeton Telegrafi. Si funksionon Zemra dihet që është një pompë që pompon gjakun. Dhe, në rastin e sëmundjeve të zemrës kemi prishje të funksionit të saj si pompë. Gjithashtu në sëmundjet e zemrës ka rëndësi si kur prishet ritmi, ashtu edhe kur prishen valvulat, ose kur prishet tërësia e mureve të saj. Kur prishet ritmi kemi aritmitë që janë dy llojesh, me ritëm të shtuar ose takikardive, ose me ritëm të ngadalësuar që janë bradikarditë. Po ashtu kur prishen valvulat zemra nuk funksionon mirë si pompë dhe në këto raste bëhen operacione të ndryshme për zëvendësimin e tyre. Po ashtu, lloj tjetër sëmundjeje të zemrës janë edhe ato që prishin muret e zemrës, siç është infarkti. Në të gjitha këto raste, duke mos funksionuar si pompë ajo nuk çon dot gjakun në të gjithë trupin dhe kështu nuk furnizohet organizmi me oksigjen edhe me lëndë ushqimore. Duke

Zemra është organi që bën pastrimin e gjakut. Dhe në rastin e sëmundjeve të zemrës kemi prishje të funksionit të saj si pompë. Kjo do të vështirësojë punën e organizmit si dhe nuk do të lejojë furnizimin e tij me oksigjen dhe lëndë ushqimore



SA I NJIHNI SËMUNDJET E ZEMRËS

mos u furnizuar me to, organizmi do të fillojë të mos funksionojë si duhet.

SIMPTOMAT

Në rastin e sëmundjeve të zemrës do të kemi shenja si marrja e frymës, ënjtje të këmbëve, nxirje e buzëve ose edhe dhimbje kur kemi infarkt për arsye se ndodh vdekje e një pjesë të murit të dhomave të zemrës. Stadi i fundit i sëmundjes së zemrës është pamjaftueshmëria e zemrës (insuficienca kardiale) në të cilën ky organ nuk e kryen funksionin e saj dhe njeriu bëhet invalid. Në momentin kur kjo pamjaftueshmëri nuk mund të përballohet nga organizmi, atëherë organizmi vdes.

GJASHTË VARIANTET E SËMUNDJES

1. Zemra e zgjeruar paraqet dobësimin e muskulit të zemrës, i cili ngadalshëm dhe dobët kontrahon me këtë dobëson qarkullimin i gjakut dhe organet nuk kanë oksigjen të mjaftuar. Si pasojë e këtyre mungesave, paraqitet dobësimi i përgjithshëm i organizmit.

2. Miokarditis është ndezje e përgjithshme e muskulit të zemrës, gjë që paraqitet si rezultat i sëmundjeve të tjera, ndonjë infeksion më i madh si gripi, reumatizmi i dhëmbëve, bajameve etj.

3. Infarkti është vdekje e një pjesë të indit muskolor të zemrës. Kjo sëmundje paraqitet nga mbyllja e ndonjë dege të arterieve të cilat

ushqejnë zemrën, gjatë kontraksionit (ngushtimit) momental të arterieve, ndonjë plasartijeje e arterieve e përcjellë me gjakderdhje, gjatë streseve ose si pasojë e shtypjes së lartë. Në këto raste indi muskolor ose një pjesë e zemrës mbetet pa ushqim dhe pa oksigjen, menjëherë pas kësaj ajo pjesë e muskulit të zemrës të vdes. Infarkti përcillet me dhimbje të rënda. Ka raste kur zemra ndërpret punën dhe shkaktohet vdekje.

4. Aritmia është rrahje e shpejtë dhe e ngadalshme e zemrës ose rrahje e përzier e ngadalësuar dhe e shpejtuar me kërcime dhe ndërprerje të rrahjeve. Kjo dukuri është pasojë e kontrollit të disharmonizuar të ngacmimeve nervore të

punës së zemrës, të cilat e kanë prejardhjen nga qendrat e sistemit nervor.

5. Arterioskleroza është grumbullimi i materieve të yndyrshme dhe kripërat e kalciumit në brendi në muret e arterieve, kjo çon deri tek mbyllja e tyre dhe zvogëlimi i qarkullimit të gjakut me shumë pasoja si dhe zmadhimi i shtypjes së gjakut, e cila mund të shkaktohet edhe nga gjendjet nervore, streset etj. Të gjitha këto kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mosfunksionimin e mirë të zemrës.

6. Embolia është mbyllja e ndonjë arterie të trurit, një lloj si infarkti i zemrës. Kjo shkakton dëmtimin e ndonjë qendre dhe me këtë rast paraqitet paraliza ose vdekja.

Një lugë mjaltë herët në mëngjes për një ditë plot energji

Nëse do të zgjidhni një term tjetër për të përshkruar mjaltin, ai me siguri do të ishte "multivitaminë". Mjalti mund të përdoret për të forcuar energjinë, sistemin imunitar, pakëson alergjitë, zbut kollën, fytyrën e lënduar dhe lufton infeksionin



Jo vetëm mjekësia popullore por edhe studime të ndryshme vlerësojnë se nisja e ditës duke konsumuar një lugë të vogël me mjaltë është mënyra ideale për t'i dhënë fuqi dhe energji organizmit përgjatë gjithë ditës. Mjalti i dhuron natyrisht fuqi organizmit, ai është antioksidant dhe armik i mikrobeve. Nisja e një dite të mbarë dhe të shëndetshme nis me patjetër nga kuzhina. Mënyra se si dalim nga shtëpia në mëngjes për t'u nisur në punë ndikon në mënyrë të pavetëdijshme në humorin tonë përgjatë gjithë ditës. Nuk është aspak i panjohur fakti

që shumica e shqiptarëve dalin nga shtëpia pa ngrënë mëngjes duke i shkaktuar organizmit drobitje dhe dobësi që në nisje të ditës. Jo vetëm mjekësia popullore por edhe studime të ndryshme vlerësojnë se nisja e ditës duke konsumuar një lugë të vogël me mjaltë është mënyra ideale për t'i

dhënë fuqi dhe energji organizmit përgjatë gjithë ditës.

VLERAT E MJALTIT PËR ORGANIZIMIN

Mjalti ka një përdorim të gjerë dhe jo vetëm si ëmbëlsues. Përpara shpikjes së antibiotikëve, mjalti përdorej gjerësisht për të trajtuar

plagët apo djegiet e lëkurës. Ai është përdorur edhe për të zbutur kollën ose si maskë lëkure, shkruan AgroWeb. Që në lashtësi, mjalti konsiderohej si një ushqim i rëndësishëm për atletët dhe njerëzit që kryenin aktivitete fizike. Por nga ana tjetër, nënat e dinë se mjalti është i rrezikshëm për fë-

mijet nën moshën 1 vjeçare, sepse shkakton botulizëm. Mjalti përmban sasi të vogla proteine, folati, vitamine C dhe vitamina të tjera të rëndësishme. Vlerat më domethënëse të mjaltit vijnë nga mineralet që ai përmban.

MJALTI SI NJË "MULTIVITAMINË"

Të dhënat e referuara nga AgroWeb.org për mjaltin provojnë se në 28 gramë mjaltë gjendet 14% e dozës së rekomanduar të manganit (bazuar në nivelin e ushqyerjes prej 2000 kalorish në ditë) dhe 8% të hekurit. Mangani dhe hekuri janë dy mineralet thelbësore, për të cilat trupi ka nevojë të luftojë sëmundjet dhe të funksionojë mirë. Mjalti është antioksidant, antibakterial dhe armik i mikrobeve.

Ai është i mbushur me vitamina dhe minerale. Nëse do të zgjidhni një term tjetër për të përshkruar mjaltin, ai me siguri do të ishte "multivitaminë". Mjalti mund të përdoret për të forcuar energjinë, sistemin imunitar, pakëson alergjitë, zbut kollën, fytyrën e lënduar dhe lufton infeksionin.

SHKËNDIJA MATEMATIKISHT KAMPIONE, FUTBOLLISTËT NË FESTË

TË BËJMË HISTORI EDHE NË EVROPË

Falë fitores me 2-0 ndaj FC Shkupi, kuqezinjtë u shpallën kampione 7 javë përpara fundit. Kuqezinjtë do tu mjaftonte edhe një barazim për të fituar titull, por humbja e Vardarit në takimin ndaj Pobedës bëri që rezultati i sfidës së zhvilluar në Tetovë të mos kishte aspak rëndësi. Një titull ky i merituar plotësisht nga skuadra e Qatip Osmanit që e ka dominuar nga fillimi e deri e tani kampionatin

Shkup, 23 prill - Misioni i realizuar me sukses. Shkëndija e Tetovës është edhe matematikisht kampione e Maqedonisë. Pas titullit të parë në sezonin 2010-2011 edhe atëherë me trajnerin Qatip Osmani në stol, skuadra tetovare ka shkruar historinë për herë të dytë duke fituar një tjetër titull në Maqedoni. Falë fitores me 2-0 ndaj FC Shkupi, kuqezinjtë u shpallën kampione 7 javë përpara fundit. Kuqezinjtë do tu mjaftonte edhe një barazim për të fituar titull, por humbja e Vardarit në takimin ndaj Pobedës bëri që rezultati i sfidës së zhvilluar në Tetovë të mos kishte aspak rëndësi. Një titull ky i merituar plotësisht nga skuadra e Qatip Osmanit që e ka dominuar nga fillimi e deri e tani kampionatin. "Jam i lumtur që Shkëndija sërish pas 7 viteve shpallet kampione e Maqedonisë. Ndryshimi i këtij titulli nga 7 vite më parë është që tashmë Shkëndija është një klub serioz, jemi duke përmirësuar dhe infrastrukturën dhe me sponsorin që kemi, Shkëndija është një klub shumë serioz dhe nuk do të ndalet me këto rezultate". tha pas ndeshjes trajneri Osmani, i cili thotë se ai dhe djemtë e tij nuk do të ndalen me kaq dhe se objektivi i radhës mbetet trofeu i Kupës së Maqedonisë. "E përsëris edhe njëherë, Shkëndija nuk do të ndalet me kaq tashmë synojnë të fitojmë Kupën dhe më pas të shohim. E rëndësishme është të ruajmë këtë grup, por do të kërkojmë edhe 2 lojtarë kualitativë që të shtojmë cilësinë e skuadrës", deklaroi Osmani. Ndryshe, Besart Ibraimi është një nga heronjtë e Shkëndijës në këtë sezon. Me finalizimin ndaj Shkupit, sul-



muesi i kuqezinjtë arriti kuotën e 19 golave në kampionat duke barazuar kapitenin Ferhan Hasani në krye të listës së golashënuesve. Por më shumë sesa për golat Ibraimi është i lumtur që Shkëndija arriti objektivin sezonal që ishte fitimi i titullit kampion. "Ishte një titull i merituar për ne. Jemi një grup i bashkuar kemi dhënë maksimumin që nga fillimi e deri në fund, ndërsa tashmë kemi objektiv edhe Kupën e Maqedonisë të cilën do të përpikemi ta sjellim në Tetovë", tha për emisionin "Gol pas Goli" në "Supersport", golaedori i kuqezinjtë. Pas suksesit të arritur, ka folur edhe kapiteni Ferhan Hasani. "Jemi shumë të kënaqur për këtë titull sepse e kemi merituar. Kemi arritur një objektiv, por duam të triumfojmë edhe në Kupë. Pas titullit në 2011-ën ky është kampionati i parë i fituar nën sponsorizimin e 'Ecolog' dhe jemi krenarë për këtë gjë", u shpreh për "Supersport", kapiteni Ferhan Hasani. "Realisht ne kemi dhënë maksimumin gjatë gjithë sezonit, dita e bukur duket që në mëngjes dhe ne e treguam veten tonë me sfidat që zhvilluam në Evropë. E dominoam kampionatin fituam ndaj rivalëve tanë kryesorë sidomos Vardarit dhe të kesh këtë diferencë nuk mund ta thuash se ky kampionat

JU LUMTË SHKËNDIJË

Jam i lumtur që erdhi koha ta shikojmë skuadrën e Shkëndijës kështu të konsoliduar, kompakte e me vetëbesim të plotë. Unë e çmoj lart frymën e harmonisë brenda skuadrës por edhe brenda klubit në përgjithësi. Kjo frymë pozitive është atributi që skuadrës i sjell siguri dhe guxim përballë cilësdo skuadër në fushën e gjelbër. Sado që për Shkëndijën kampionati tashmë quhet i mbaruar, skuadrën e presin sfida të reja për të cilat duhet të punohet me përkushtim dhe unë jam i bindur se të gjithë ju në klub, lojtarët, stafi teknik dhe menaxhmenti, për këtë jeni të vetëdijshëm dhe do ta bëni më të mirën për të vazhduar ecjen në rrugën tuaj drejt sukseseve të



reja. Sukseset e këtylla të skuadrës kanë qenë ndër synimet tona dhe sigurisht që na motivojnë për t'i qëndruar pranë klubit e për ta përkrahur gjithnjë e më shumë. Me rastin e shpalljes së KF Shkëndija kampion të këtij stinori po jua përcjell urimet e mia më të mira ju lojtarëve, stafit teknik si dhe menaxhmentit të klubit. Në mënyrë të veçantë ju uroj gjithë juve mijëra tifozëve që me ëndje e ndiqni skuadrën tuaj të zezër si dhe ju 'Ballistëve' që gjithmonë jeni aty ku janë kuqezinjtë e Shkëndijës suaj duke e mbështetur skuadrën e zezër në mënyrë gjithnjë e më të civilizuar. Urime të gjithëve së bashku! Paçi shëndet dhe suksese me fitore dhe arritje të reja!

ka qenë i lehtë për ne por e kemi fituar me meritë të plotë", shprehet në anën tjetër mbrojtësi i majtë Ardian Cuculi. Ndërkohë, i ftuar në emisionin "Zona Gol" në "Supersport" ka qenë edhe presidenti i Shkëndijës, Visar Bexheti, i cili pos suksesit goli edhe për ambiciet e klubit në të ardhmen. Absolutisht titulli është vetëm hapi i parë, shpresoj të fitojmë edhe Kupën e Maqedonisë dhe më pas të shkojmë në Evropë. Komplimentet shkojnë për lojtarët në radhë të parë dhe stafin teknik që kanë bërë një punë të shkëlqyer. Por, falënderimet tona shkojnë edhe për kompaninë 'Eco-

log' dhe familjen Destani që kanë investuar paratë e tyre te kjo skuadër", u shpreh Bexheti, i cili tha se synimi i kryesisë së klubit dhe stafit teknik është që të ruajnë grupin aktual të futbollistëve sepse duan të shkojnë larg me këtë skuadër. Ndryshe, Bexheti ka folur edhe për projektin e klubit kuqez. "Pas këtij suksesi do të vazhdojmë të punojmë më fuqishëm që të jemi në të ardhmen edhe më të suksesshëm. Do fillojmë që tani të mendojmë për pjesëmarrjen në Evropë. Do të mundohemi ta ruajmë këtë grup futbollistësh dhe të afrojmë ndonjë lojtarë cilësorë. Në Maqedoni do të tentojmë të fitojmë rregullisht titullin", shtoi më tej Bexheti. Në fund, presidenti i klubit ka folur edhe për stadiumin e qytetit në Tetovë. "Besoj që vitin e ardhshëm stadiumi do të jetë gati. Po punojmë në këtë aspekt dhe besoj që do t'ia dalim. Ideja është për të rikonstruktuar stadiumin e vjetër, por nuk përjashtohet mundësia që të ndërtojmë dhe një stadium të ri", deklaroi Visar Bexheti. Tashmë deri në fund të sezonit, objektivi i mbetur për Shkëndijën është të grumbullojë sa më shumë pikë dhe të fitojë edhe Kupën e Maqedonisë duke bërë "double" në këtë sezon.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 04A/2018

për punësimin e 2 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Shkollën Shtetërore të Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve me të Pamurit e Dëmtuar Dimitar Vlahov Shkup “për vendet e punës në vijim:

1. OBN 0102V01001 Këshilltar për çështje të përgjithshme dhe normative juridike - Sekretar, Njësia për çështje normative - juridike, burime njerëzore dhe çështje të përgjithshme

1 realizues(ë)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 21.500,00 denarë

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkenca juridike/ekonomike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Rom(e) 1.

2. OBN0102G01008 Referent i pavarur për kontabilitet - Kontabilist, Njësia për financa dhe kontabilitet

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, Arsim ekonomik
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar
- mësim dhe zhvillim
- komunikim

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 16.900,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 32/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101G04000 Referent i pavarur për negociata dhe integritet, Njësia për negociata dhe integritet në Bashkimin evropian, Sektori për Bashkimin evropian

1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, teknik administrativ
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 15.533,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



IPSH QENDRA E SHËNDETIT PUBLIK TETOVË



Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 33/15, 72/15 dhe 129/15, Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-2781/2 të datës 08.03.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-332/1 të datës 23.04.2018 nga U.D Drejtori i IPSH Qendra e shëndetit publik Tetovë dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Qendër, publikohet:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin të 5 (pesë) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar për dërgim në specializim

1. IPSH Qendra e shëndetit publik Tetovë ka nevojë për punësim të:

1.1. 5 (pesë) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar për dërgim në specializim.

2. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e përgjithshme të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore edhe atë:

- të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
 - të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
- Për kandidatin nën pikën 1.1**
- Arsim sipëror të mbaruar shkallë të VII/1 - Fakultetit të medicinës
 - licencë për punë
 - me ose pa përvojë pune,
4. Orari i punës është 40 orë, 8 orë pune në ditë prej ora 07:30 deri në ora 15:30. Neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës është 32.158,00 denarë.
5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim
- Për kandidatin nën pikën 1.1**
- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt,
 - Biografi të shkurtë (CV),
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
 - Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
 - Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
 - Diplomë me sukses mesatar për fakultet të mbaruar të mjekësisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,
 - Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane),
 - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

8. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktorë të medicinës të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.

9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Qendra e shëndetit publik Tetovë rr. 29-ti Noemvri nr. 73, përmes postës ose në arkivin e IPSH Qendra e shëndetit publik Tetovë, ndërsa me shenjë për Shpallje publike për punësim.

Në pajtim me:

Shërbimin juridik:

Financat:

23.04.2018

Tetovë

IPSH Qendra e shëndetit publik Tetovë

U.D Drejtor

MDSç Afrim Shehapi

08-PK-7.5-4/1 | 29.Noemvri nr.73 | tel +389(44) 331233/ 333499; faks +389(44)335754 ;

e-mail zzzte@t-home.mk

TRAJNERI I NAPOLIT, MAURIZIO SARRI I KËNAQUR ME FITOREN POR PRANON

GJITHSESI, GJITHÇKA ËSHTË NË DUART E JUVENTUSIT

"Kjo fitore sonte ishte një kënaqësi e madhe për ne, – tha ai. – Djemtë ishin të lumtur, festuan në dhomat e zhveshjes. Por, asgjë nuk ka ndryshuar. Juventusit mbetet përpara një pikë dhe është gjithçka në duart e tij", pohon Sarri



Gëzim i madh në shtëpinë e Napolit për suksesin "in extremis" në fushën e Juventusit, që ka rihapur në fakt luftën e "Scudetto" në Seria A, katër ndeshje pa mbaruar kampionati. Trajneri napolitan, Maurizio Sarri, i cili foli në mikrofonët e "Sky Sport" dhe "Mediaset Premium", nuk e fsheh gëzimin, por përipiqet t'i mbajë të tija me këmbë në tokë. "Kjo fitore sonte ishte një kënaqësi e madhe për ne, – tha ai. – Djemtë ishin të lumtur, festuan në dhomat e zhveshjes. Por, asgjë nuk ka ndryshuar. Juventusit mbetet përpara një pikë dhe

është gjithçka në duart e tij. Sonte ne mund të gëzojmë për këtë fitore të shkëlqyer, por nga nesër do të duhet të mendojmë për ndeshjen kundër Fiorentinës", u shpreh Sarri. "Një lojë shumë e vështirë për ne, në një fushë tradicionalisht të vështirë. Fitorja këtu, ndërkohë, është gjithmonë diçka e mahnitshme, sepse ato u japin kënaqësi tifozëve tanë. Nga

pikëpamja e rezultateve, Juve përfaqëson pushtetin. Flasim për një ekip, ndaj të cilit të gjithë do të duan për të fituar. Dhe, kur ndodh, përjeton një kënaqësi të madhe. Fatkeqësisht, kampionati është në duart e bardhezinjve, forca e tyre është e tejskajshme. Fitorja erdhi si pasojë logjike. Ajo dukej një blasfemi për të ardhur këtu dhe përmes një goditjeje këndi në limitin

e kohës së rregullt. Të vish këtu për të marrë një rezultat maksimal për të imponuar ndeshjen kundër një skuadre si Juventusit, është gjithmonë e vështirë dhe e rrezikshme", deklaroi trajneri i Napolit.

Në anën tjetër, Massimiliano Allegri këmbëngul se Juventusit është ende në kontroll të garës së Seria A, pavarësisht humbjes. "Ish-te një lojë e tmerrshme nga të dyja

skuadrat, – tha ai. – Nuk kishte pothuajse asnjë goditje për gola. Ne kishim disa vështirësi, por duhej ta kishim marrë fundin me më shumë kujdes, sesa të prananim një gol nga një goditje këndi. Është një rast kokë më kokë dhe çdo gjë mund të ndodhë në ato situata. Tani kemi një ditë pushimi, pastaj duhet të përgatisim ndeshjen vendimtare për sezonin tonë, kundër Interit", tha Allegri. "Ne jemi ende në krye të klasifikimit, ende kemi përparësi. Janë edhe katër ndeshje për t'u luajtur, dy në shtëpi dhe dy larg, kështu që ne do të shohim se çfarë mund të ndodhë. Napoli e meriton në njëfarë mënyre fitoren, por nuk kishte pothuajse asnjë shans. Ata duhej të fitonin, ne duhej që të fitonim, ose barazim. Ekziston një avantazh tjetër, pasi diferenca e golave është në favorin tonë. Ne duhet ta analizojmë mirë këtë ndeshje dhe të përgatitemi për të ardhmen. Kjo do të jetë shumë e rëndësishme", përfundoi Allegri.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1, paragrafi 2 dhe 3, nenit 23 ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015), nenit 82 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 103/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010; 18/2011; 42/2011; 51/2011; 6/2012; 100/2012; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 135/2014; 10/2015; 98/2015; 145/2015; 30/2016; 127/2016 dhe 67/2017) dhe në bazë të pëlqimit të marrë nga MASH numër 12-4145/2 të datës 13.04.2018, SHF "Goce Dellçev" – Konçe publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të punës në vijim për vitin shkollor 2017/2018

1. Një mësimdhënës të gjuhës angleze me 20 orë mësimore (40 orë pune), si zëvendësimit të mësimdhënës në pushim të lindjes me pagesë fillestare prej 20.640,00 denarë deri në kthimin e mësimdhënës nga pushimi i lindjes.

Vendi i punës plotësohet për kohë të caktuar të punës deri në kthimin e mësimdhënës në vend të punës e cila është në pushim të lindjes, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e parapara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim fillor neni 77 dhe neni 80.

Orari i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:00 deri në ora 13:30.

Krahas fletëparaqitjeve për vendet e punës kandidatët duhet të parashtrorin dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës dhe certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet e parashtruara të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin e shkollës.

Shpallja zgjatet 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes publike.

Lutjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

SHF "Goce Dellçev" – Konçe
UD Drejtor: Cveta Angellova



REPUBLIKA E MAQEDONISË MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 10620/08, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 33/15, 72/15 dhe 129/15), Ministria e shëndetësisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të tre (3) këshilltarëve të posaçëm në Kabinetin e ministrit të shëndetësisë, për kohë të caktuar

1. Këshilltar i posaçëm në kabinetin e ministrit të shëndetësisë për çështje që kanë të bëjnë me shëndetësinë (3) realizues

- Përgatitje sipërore profesionale (VII/1) ose së paku 240 kredi sipas SETK, shkencat juridike, shkencat ekonomike ose shkencat politike
- Së paku 5 vjet përvojë pune në profesion
- Njohje të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të huaj
- Punë me kompjuter
- Neto pagesa: prej 35.000,00 deri në 55.000,00 denarë
- Orët e punës në javë: 40, orari i punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30, ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte. Si kushte të posaçme për punë në Kabinet parashihen: punë gjatë kohës së pushimit javor, punë gjatë festave të përcaktuara me ligj, për shkak të realizimit të punëve urgjente dhe që nuk mund të shtyhen.

Këshilltarët e posaçëm në kabinetin ministrit do të punësohen për kohë të caktuar për periudhë deri në kalimin e mandatit të ministrit.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorin dëshmitë për përmbushje të kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter:

1. Dëshmi të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
2. Dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
3. Dëshmi për vendim të plotfuqishëm gjyqësor se nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
4. Certifikatë diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
5. Dëshmi për përvojën e punës dhe
6. Biografi të shkurtë

Kandidatët e interesuar dokumentet në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter i parashtrorin në arkivin e Ministrisë së shëndetësisë ose përmes postës në adresën: Ministria e shëndetësisë – rr. "50 Divizija" nr. 14, Shkup me shenjë "Për shpallje publike për Këshilltar të posaçëm në kabinetin ministrit". Fletëparaqitjet e parashtruara përmes postës, duhet të pranohen në arkiv më së voni deri në ditën e përfundimit të afatit të shpalljes publike. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Shpallja publike do të zgjasë 5 (pesë) ditë, duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes në gazetën ditore.

Dokumentacioni i arritur do të shqyrtohet nga ana e Komisionit të përbërë prej tre anëtarëve të formuar nga ministri i shëndetësisë në afat prej tre ditëve pas përfundimit të shpalljes publike.

MINISTËR,
Doc. D-r Venko Filipçe

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093



Republika e Maqedonisë Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit nga lumi Bezgashka për kultivimin e peshqve në KK Rusinovë, Komuna e Berovës.

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16) deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë është dorëzuar kërkesë për dhënie e Lejes për përdorimin e ujit për rritjen e peshqve prej lumit Bezgashka në PA me nr. 11-5-247/2018 nga 22.02.2018, në KK Rusinovë, Berovë.

Parashtruesi i kërkesës
Zoranço Madevski
Fshati Rusinovë nr. 20
Berovë

Koordinon nga pika e kapjes dhe pikën e shkarkimit:

Pika e kapjes së ujit nga Bezgashka Reka:
Y=7 646 708m, X=4 608 900m;
Pika e kapjes së ujit nga Bela Voda:
Y=7 646 738m, X=4 608 935m;

Pika e shkarkimit:
Y=7 646 658m, X=4 608 925m;

Informata në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail: n.pavlovska@moepp.gov.mk
Opinionin i përfshirë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi Goce Dellçev nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

Rikthehet në skenë Liga e kampionëve, ku në program do të jenë ndeshjet gjysmëfinale. Sfida e parë do të zhvillohet sonte (e martë) në "Anfield Road" ndërmjet Liverpoolit dhe Romës, dy ekipet të cilat në çerekfinale eliminuan Mançester Sitin, respektivisht Barcelonën

TE ROMA KANË BESIM

SALLAHUN DO TA NDALIM ASHTU SI NDALËM MESSI



Liverpul-Roma do të jetë përballja e parë e gjysmëfinale së "Champions League". Gjigantët anglezë pasi eliminuan Mançester Sitin në çerekfinale, shorti i ka vënë përballë djemve të Di Franceskos, të cilët u treguan të zotët në sfidën ndaj Barcelonës dhe siguruan një biletë për këtë fazë. Ndryshe, Jurgen Klopp duket që është i përqendruar maksimalisht për takimin e sotëm që do të luhet në "Anfield" në orën 20:45. Liverpooli u ndal në një barazim 2-2 ndaj Uest Brom në fundjavë në Premier Ligë, ndërsa kërkon që të sigurojë finalen e Kievit në përballjen ndaj verdhekuqve. Me treshen e sulmit, Salah-Firmino-Mane, tekniku gjerman shpreson që të jetë produktive në sfidën e mbrëmjes së sotme. Por, nga ana tjetër edhe Di Francesco me "gladiatorët" e tij do të bëjë maksimumin për të shkuar në finale. Megjithatë, se cili prej tyre do të sigurojë një biletë për në Kiev do të shohim në minutën e fundit të sfidës që do të luhet në "Olimpico" javën tjetër. Cekim, "Të kuqtë" fituan me rezultatin e

përgjithshëm 1-5 ndaj kampionëve të Premier Ligës, Mançester Sitit të Pep Guardiols ndërkohë që kryeqytetasit italianë përmbysën gjithçka në shtëpinë e tyre pas humbjes 4-1 në "Camp Nou", verdhekuqtë triumfuan 3-0 në "Olimpico". Fitore dhe përmbysje e jashtëzakonshme nga djemtë e

teknikut 48-vjeçar që arriti t'u dhurojë emocione të jashtëzakonshme tifozëve. Te Roma besojnë se mund ta ndalin golashënuesin më të mirë të Premier Ligës, Mohamed Sallah, ashtu si ndalën Lionel Messin. Këtë e pohon mbrojtësi Kostas Manolas, i cili shënoi golin vendimtar për kualifikimin e

verdhekuqve. "Nuk do të markojmë Sallah një për një, sepse ne e ndalëm Barcelonën dhe Lionel Messin duke luajtur të gjithë bashkë si ekip, këtë do të bëjmë edhe këtë herë. Nuk do të jetë e lehtë, por jemi gati dhe do ta ndalojmë Sallah të gjithë së bashku," – tha Manolas për "La Stam-

pa". "Futbolli ynë ka të bëjë me mentalitetin dhe filozofinë që na jep trajneri. Ne luajmë gjithmonë me të njëjtat ide, pavarësisht se cili është kundërshtari. Ai është një trajner modern që kërkon ta dominojmë lojën me presing dhe ritëm të lartë," – deklaroi mbrojtësi grek.

Sallah fiton çmimin "Futbollisti i Vitit"

Egjiptiani Mohamed Sallah është zgjedhur futbollisti më i mirë i vitit në Premier Ligë nga Shoqata e Futbollistëve Profesionistë në Angli. 25-vjeçari, që mbërriti te Liverpooli gjatë verës së kaluar nga radhët e Romës, ka shënuar plot 41 gola me "The Reds" në të gjitha kompeticionet, duke rezultuar një goditje e madhe në merkato për skuadrën e gjermanit Jurgen Klopp. Sallah është futbollisti i dytë afrikan, pas Rijad

Mahrez, që e merr këtë çmim. "Faraoni" i Liverpoolit në fazën finale të votimit ka mposhtur konkurrencën e emrave të rëndësishëm si Kevin De Bruine, Leroy Sane, David Silva, Harry Kin apo Markus Rashford. Sallah është favorit për të fituar edhe "Këpucën e Artë" në Evropë, pasi kryeson listën e golashënuesve në kampionatet kryesore evropiane me 31 gola, dy më shumë se rivali i tij madh, "ylli" i Barcelonës, Lionel Messi.



Nuk kam asnjë problem me Murinjon

Pol Pogba u transferua nga Hoze Murinjo për një shumë rekord te Mançester Junajtedi, 89.3 milionë euro. Ai erdhi nga Juventus në gusht 2016, për t'u kthyer në "Old Trafford" në një eksperiencë të dytë. Futbollisti francez, megjithatë, ka duruar fatin e përzier këtë sezon dhe ka kaluar kohë në stol, në vitin 2018, pasi forma e tij është jo e duhura. Fitortja 2-0 në Premier Ligë, kundër Burnmaut, dhe suksesi gjysmëfinal i "FA Cup", 2-1 ndaj Totenhemit, në "Wembley" i ka qetësuar disi gjërat te "dajtë e kuq". "Unë

nuk kam asnjë problem me të, – tha Pogba për "Canal Football Club". – Jam pjesë e një klubi të madh, si Mançester Junajted. Jam futbollist me ambicie dhe më pëlqen të jap më të mirën nga vetja ime. Ai është trajner, ai i merr vendimet. Si lojtar, i pranoj ato", u shpreh Pogba. Ai e hodhi poshtë, gjithashtu, sugjerimin se ulja disa herë në stol e bën atë të "peshojë" të ardhmen. "Unë nuk mendoj kështu, – shtoi ai. – Nëse luan diku sh tjetër në vendin tim, kjo nuk është padrejtësi. Ndoshta vetëm për shkak se trajneri po kërkon

dicka tjetër. Ne lojtarët duhet ta pranojmë këtë. Ndoshta ishte rasti për Romelu Lukaku, ose Marouane Fellaini", shtoi më tej francezi në radhët e Junajted. Pep Guardiola shkaktoi "trazira" kohët e fundit, duke pretenduar se Pogba ishte ofruar Mançester Sitit në janar, nga Mino Raiola, por vetë lojtari nuk është i shqetësuar nga raportet e tilla. "Tani për tani po mendoj për të tashmen, "FA Cup" dhe Kupën e Botës që vjen. Nuk po mendoj për transfertat, apo ndonjë gjë nga këto", përfundoi Pogba.





DASHI 21. mars - 20. prill

Dite mjaft premtuese kjo e sotmja për te dashuruarit. Do e vlerësoni shumë përkrahjen që partneri iu ka dhënë kohët e fundit dhe do keni me tepër besim tek ai. Beqaret do kenë shumë takime, por do e kenë të vështirë të vendosin për personin e duhur. Për financat do jete dite e qete dhe pa probleme. Hiqni ndonjë para mënjane nëse doni që edhe ditët në vazhdim të jene te mira.



DEMI 21. prill - 21. maj

Jeta sentimentale e çifteve do jete shume e qete. Kjo do iu krijojë atyre mundësinë të flasin për disa tema delikate dhe me ne fund t'iu japin nga një zgjidhje. Beqaret do kenë dashuri me shikim të pare gjate kësaj dite. Me ne fund edhe ata do ndihen te plotësuar. Ne planin financiar duhet te bëni kujdes me shpenzimet si dhe me transakcionet që do kryeni.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Tregohuni me te kujdesshem kur te flisni me partnerin tuaj sot dhe mos mendoni se çdo gjë që mund t'i thoni ai mund ta gëlltisë. Mos krijoni kot se koti debate apo probleme. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim, pa arritur te gjejnë personin e përshtatshëm. Për financat do jete dite mese e qete. Ruajeni sa te mundni këtë situatë sepse vetëm kështu mund te fillojnë edhe përmirësimet.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dite përgjithësisht pozitive dhe aspak problematike kjo e sotmja për te dashuruarit. Do kuptoheni me se miri me njeri-tjetrin dhe do i harroni mosmarrëveshjet që keni pasur dikur. Beqaret ka shume gjasa te bien ne dashuri me personin e duhur. Gjerat do jene reciproke nga te dyja anët. Financat fatmirësisht nuk do jene aspak problematike, mos u shqetësoni.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse keni shume kohe ne një lidhje dashurie, sot do filloji te mendoni për një te ardhme me te sigurte. Një periudhe shume e bukur po iu pret. Beqaret do kenë vetëm mundësi për aventura. Nëse i preferojnë le te përfitojnë, përndryshe do duhet te presin gjate. Ne planin financiar situata do jete mjaft delikate. Shmangni çdo lloj investimi dhe mos i shlyeni tani borxhet.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ne jetën tuaj ne çift do ndodhin gjera te mrekullueshme gjate kësaj dite. Emocionet do jete te forta dhe te njëpasnjëshme. Do ndiheni me se miri kështu që shfrytëzojeni ditën. Beqaret do joshen nga dikush që nuk vlen aspak. Mos u nxitoni te merrni vendime te menjëhershme sepse do vuani shume. Financat do vazhdojnë te jene ne te njëjtën situatë si disa kohe me pare.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Marrëdhënia ne çift do jete edhe me e ngrohte gjate kësaj dite. Do kuptoheni me se miri me partnerin dhe do i zgjidhni një nga një te gjitha problemet që keni pasur. Beqaret do kenë te papritura te këndshme, por jeta e tyre do marre një tjetër drejtim duke filluar që sot. Ne planin financiar duhet te kufizoni shpenzimet nëse doni që situata mos ketë probleme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Ka shume mundësi që partneri t'iu beje një propozim emocionuese sot. Përgatituni shpirtërisht sepse nga përgjigjja që do jepni do varet e ardhja juaj. Beqaret do ndihen mire ashtu si janë dhe nuk do kërkojnë një person që ta kenë ne krah. Ne planin financiar nuk duhet te ndërmerri shume rreziqe për ta përmirësuar situatën. Tregohuni te kujdesshem.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Dite e tensionuar dhe e mbushur me debate për ata që janë ne një lidhje. Asgjë nuk do shkoje ashtu si ju e kishit menduar, kështu që bëni kujdes. Beqaret nga ana tjetër do jene me fat dhe do e gjejnë personin që kane kërkuar prej kohesh. te ardhurat gjithashtu do fillojnë pak nga pak te stabilizohen. Mundohuni te shmangni shpenzimet e mëdha për disa kohe.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Tregohuni me realiste gjate kësaj dite për jetën tuaj ne çift dhe mos ëndëroni me shume sesa duhet. Vetëm ne këtë mënyrë lidhje juaj do ece ne rrugën e duhur. Beqaret do kenë një takim te veçante me një person te cilin e kishin ëndërruar që prej kohesh. Ne planin financiar dëgjojeni këshillat që do iu japin disa te afërm sepse do iu ndihmojnë jashtë mase.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Dite jo shume e mire kjo e sotmja për marrëdhënien ne çift. Do keni debate serioze me partnerin dhe do iu duket sikur zymtësia do iu mbuloje përgjithmonë. Beqaret mund te kenë edhe dashuri me shikim të pare kështu që duhet t'i bëjnë sytë katër. Jupiteri do iu sjelle shume fat me financat, megjithatë maturinë nuk duhet ta humbni për asnjë moment.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do keni disa keqkuptime gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift sot, por gjithçka mund te zgjidhet shpejt nëse tregoheni te matur e te kujdesshem. Beqaret do kenë një dite te mbushur me emocione dhe me te reja. Shfrytëzojeni sa me shume që te mundeni. Financat do jene ne gjendjen e tyre me te mire. Mund te bëni edhe ndonjë shpenzim me tepër sot.

GJYNAH PARTI POLITIKE NË MAGEDONI	M	ANOHET, PRIRET AFAT, KOHË (VJET.)	P	KAMBANË	JEMENI	KLUB GREK	POLITIKANI SHQIPTAR NË FOTO	SPANJA	PARTIA E POLITIKANIT NË FOTO USHTRIME FIZIKE	P											
L																					
PËRPARIM I SHPEJTE NË NËJE FUSHË TE CAKTUAR								PRISHTINA ZORRO													
KËNGËTARJA ANGLEZE, LORI BLU ADKINS					EMËR ME TË CILIN SHERBYESI TERRISTE TE ZOTIN KELVINI																
KLUB TETOVAR								RIMINI JO LARGIMI													
<div style="position: absolute; top: 10px; right: 10px; border: 1px solid black; padding: 2px;"> NE KETE DATE 24 PRILL 1957 </div>																					
											KËSTI										
											TEFTA KOÇO								GJERMANIA DY (ANG.)		
											VEKTORË NJESI PRODUKT HASHASHI										
											O										
											IBRAHIM MUÇAJ								OZONI ELEMENT KIMIK		
											Mensur Mamuti						BOJË (ANG.) AUTORI YNË, ISMAIL				
											KALIU MI KARTELE CELULARI							ERBIUMI ALKAL I DERIVUAR NGA METANI			
											POSTI I POLITIKANIT NË FOTO (2007-2012)	VATAN	FUJE E TJERRË PREJ PAMBUKU PËR QEPJE (SHQ.)	ZUIT	JO E VJETËR	SHTETI ISHULLOR NE OQ. E QETE BITUM NATYROR					
											I										
TË VËRTETAT SHKENCORE, QË DUHET VERTETUAR LLOJ QENI									INTENSITETI NOTË MUZIKORE												
T						FAT, KËSMET TEMPERATURA															
POETI ROMAK, LUKRECI					PUNËTORI E PIKTORËVE																

ZGJIDHJET: M, P, P, LËVIZJA BESA, KARRIERA, PR, ADEL, IMZOT, TETEKSI, RI, RATA, TF, D, ORTE, OPIM, IM, O, INK, K, ER, SAMOA, ISH PRESIDENT, TEOREMAT, I, TERIER, RISK, TIT, ATELIE.

shumë i lehtë

9			5				6
	1	6		9	8	2	
							7
			9	4	3		
8			1		5		3
		4	8	6	2	1	
	7						3
		1		8	7		9
4			6				7

Sudoku

mesatar

1				7				5
					2			
	3	6	1			9	2	
3					6	1		
			4			5		
		2	5					6
	9	1	4			2	5	
					9			
2				3				7

Shumë i lehtë: 927514386, 316798245, 548236971, 165943728, 892175463, 734862159, 679451832, 251387694, 483629517. Mesatar: 129374865, 548692371, 736185924, 357946182, 614728539, 982513746, 891467253, 473259618, 265831497.



Arrestohet kuzhinierja pasi kapet me... miell!

Mary Berry ka zbuluar se ishte arrestuar njëherë nën dyshimin e trafikimit me drogë në SHBA – pasi kishte paketuar miell në valixhen e saj. Kuzhinierja e njohur angleze, 83-vjeçe, foli hapur për përvojën e saj të hidhur me ligjin gjatë emisionit "The Graham Norton Show" – ku e pranoi se kjo përvojë ishte "alarmues", raporton "Pagesix". "U arrestova 25 vjet më parë. Po shkoja në SHBA për të demonstruar disa gatoja dhe brengosës se nuk mund t'i gjindja të gjithë përbërësit, kështu që mora me vete miell e sheqer dhe i vendosa në qese të vogla plastike. Kur erdha në aeroport, qentë nuhatës më nuhatën dhe papritmas u rrethova nga njerëz të uniformuar dhe unë e asistenti im u vendosëm nëpër qeli të ndara", tregoi Berry. Ajo tha se e tërë kjo përvojë ishte "alarmuese" dhe shtoi: "Kur më pyetën nëse do të fitoja para nga 'malli', u thash, 'Po, dhe tarifa ime tashmë është paguar'. Ylli televiziv është e njohur më së shumti për emisionin "Great British Bake Off", e po ashtu ka qenë kuzhinierja e njohur në vitet '70 dhe '80.

Kur Madona punonte kameriere

Ajo ishte një kameriere e tmerrshme nuk puna në këtë profesion nuk i zgjati shumë. E kush mund ta mendojë se ylli i muzikës botërore e ka nisur karrierën nga gjërat e thjeshta. Është e vështirë të imagjinohet tani, që ylli i muzikës njëherë e një kohë u pushua nga puna te Dunkin' Donuts, një kompani e njohur që bën petulla amerikane dhe ka një grup kafenesh. Në atë kohë, këngëtarja kishte lënë kolegjin dhe ishte zhvendosur në Nju Jork, në kërkim të famës. Por kohët ishin të ashpra, ndaj ajo pranoi një punë të thjeshtë për të bërë disa para. Ajo u pushua pasi aksidentalisht derdhi xhelatinë petullash mbi një klient. Jeta e saj nuk ka qënë aspak e thjeshtë të paktën fillimet, ndaj Madona ka refuzuar dhe idenë e hedhur për një film biografik për fillimet e karrierës së saj. Rruga e famës për Madonën nisi në 1978 në Nju Jork, kur ajo takoi fotografin Michael McDonnell. 20-vjeçarja e veshur e gjitha në të zeza me



xhinse të grisura dhe flokët me onde, kishin tërhequr vëmendjen e fotografit. Ai i kërkoi Madonës që të pozonte për atë dhe këngëtarja e pranoi kërkesën. Më pas ata kanë punuar bashkë për 8 muaj. McDonnell nuk zbuloi tek ajo vetëm pamjen e jashtme por edhe karakterin e yllit të muzikës që së shpejti do të bëhej e famshme. Por përtej këtyre detajeve duket se fëmijëria dhe fillimet e karrierës nuk kanë lënë gjurmë të bukura në memorien e këngëtares, e cila refuzon herë pas here idetë e hedhura për të bërë një film apo një libër mbi jetën e saj.



Qeni kujdeset për vajzën e vogël të zhdukur

Policia në Australi ka shprehur mirënjohje për një qen, i cili ka qëndruar me një vajzë 3 vjeçare e cila kishte kaluar natën në shkurre. Vajza e vogël kishte humbur dhe për të zhvillohej një kërkim i madh. Mirëpo, ajo nuk mbeti e vetme. Kjo, sepse qeni i fa-

miljes i vjetër plot 17 vjeç, e kishte ndjekur atë. Qeni qëndroi me vajzën për 16 orë të tëra, derisa ajo u gjet nga familja. Të afërmit kanë bërë të ditur se vajza qëndroi e strehuar me qenin nën shkurre dhe tani vuan vetëm disa lëndime të vogla, shkruan BBC.

Gjermani, tregtohen hamburger me krimba

Një sandviç me sallatë, domate dhe një hamburger. Gjithçka normale nëse nuk ishte se nuk ishte me mish viçi, por me krimba. Në Aachen, Gjermani, një supermarket filloi të shiste pjatën e re, pasi Holanda, Belgjika dhe Zvicra ia dolën me sukses. Konsumatorët duket se e vlerësojnë. Sekretit? Ata duken njësoj si 'burgers' tradicionale. "Insekten Burger" mund të lexohet në pako. Lënda e parë është në të vërtetë një krimb i asaj që në shumë vende quhet "kacabu i buallit". Këto janë Tenebrionidae, një familje insektesh, të cilave gjithashtu i përkasin krimbat e miellit. Rriten në Holandë dhe tani janë shitur në Gjermani vetëm nga supermarketi ReWe në Aachen. Manfred Rödder, një kalimtar i zakonshëm, i tha "The Guardian" se ai kishte disa dyshime në fillim, por pastaj "i bleva ato përsëri, sepse ata dukeshin shumë të mira". Sipas Baris Özel, bashkë-themelues i Bigfoun-



dation, ylli i cili krijoi "burgers krimb", sekretit është në dukje: ata janë të njëjta si ato të mishit. Ideja erdhi pas një udhëtimi në Azinë Juglindore, ku insektet janë një pjatë e zakonshme. Propozime të ngjashme mund të gjenden edhe në Holandë dhe në Belgjikë dhe vitin e kaluar ato mbërritën edhe në supermarkete zvi-

cerane. "Disa njerëz janë entuziastë dhe vazhdojnë të kërkojnë", tha menaxheri i dyqanit, Michael Reinartz, "të tjerët na pyesin" po e bëni seriozisht?. Por ai është i bindur: "Kur do të jetë normale të gesh burgerë të krimbave, do të kujtojmë si ata që i kanë shitur ato së pari në Gjermani", shtoi ai për shtypin gjerman.

1184 BC – Grekët futen në Trojë duke përdorur Kalin e Trojës (dita tradicionale).
858 – Nikolla I trashëgon Benediktin III si papë
1558 – Mbretresha Mari Stjuart nga Skocia martohet me Princin francez François
1570 – Beteja mes trupave spanjoll dhe ithtarëve të Sulltan Sulejmanit
1762 – Rusia dhe Prusia nënshkruajnë traktat të paqes
1792 – "La Marseillaise" komponohet nga Claude-Joseph Rouget de Lisle
1872 – Shpërthen vullkani i Vezufit
1877 – Lufta ruso-turke 1877-1878: Rusia i shpall luftë Perandorisë Osmane
1898 – Lufta amerikano-spanjolle: Shtetet e Bashkuara i shpallin luftë Spanjës
1920 – Trupat polake sulmojnë Ukrainën
1921 – Zgjedhjet e para lokale për burra dhe gra në Belgjikë
1953 – Uinston Çerçill shpallet kalorës nga Mbretresha Elizabeta II
1954 – Australia dhe BRSS ndërpresin marrëdhëniet diplomatike
1969 – Trupat libaneze në betejë me palestinezët
1970 – Senegali miraton kushtetutën
1981 – SHBA përfundon embargon e drithit kundër BRSS



Jetëgjatësia e një kartëmonedhe lidhet edhe me vlerën nominale të saj. Përgjithësisht, prerjet e vogla e kanë jetëgjatësinë 2-3 vjet, prerjet e mesme 3-5 vjet, ndërsa ato të mëdha mbi 7 vjet. Nga pikëpamja e qarkullimit, kartëmonedhat me prerje të vogël më së shumti ngelen nëpër dyqane dhe qarkullojnë disa herë deri në momentin e depozitimit në sportelet e bankave. Rikthimi i tyre në sportelet e bankave kryhet kryesisht kur kartëmonedhat zbehen apo humbasin një pjesë të cilësive të tyre. Kartëmonedhat me prerje të madhe administrohen më mirë nga përdoruesit, duke treguar më tepër kujdes në përdorim sesa tek ato me prerje të vogël. Pra, sa më e madhe vlera nominale, aq më jetëgjatë edhe kartëmonedha.

IKËN DRITAT

Një djalë 18 vjeç i tregon shokut ngjarjen që kishte përjetuar mbrëmë.

- Isha më të dashurën time tek shtëpia saj dhe papritur ikën dritat, tha djali.

- A e shfrytëzove rastin?, pyeti shoku.

- Po po, ja piva të gjithë Coca Colen, u përgjigj 18-vjeçari.



Gjërat e mëdha bëhen nga një seri gjërash të vogla që bashkohen.

(Vincent Van Gogh)

KALENDARI HISTORIK 24 PRILL

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS